



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА

SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI JURIDIK

ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

FACULTY OF LAW

FAKULTETI JURIDIK

STUDIME PASDIPLOMIKE- CIKLI I DYTË

TEZA E MASTERIT:

Kontratet elektronike, sfidat dhe perspektivat e reja

Kandidati:

Genc Jakupi

Mentori:

Prof. dr. Arta Mero

Tetovë, dhjetor 2023

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se përmbajtja e temës së magistraturës së paraqitur është punë origjinale e shkruar prej meje, e cila nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Të gjitha referencat dhe citimet në tekst janë bërë në bazë të burimeve të paraqitura në fusnota.

Në të kundërtën pranoj të gjitha përgjegjësitë të cilat mund të më ngarkohen nga cilido komision apo organ që eventualisht do të shqyrtojë ndonjë rast ankese apo mosmarrëveshje lidhur me përmbajtjen e punimit, dhe në të njëjtën kohë pranoj të gjykohe në bazë të rregullores dhe statutit të Universitetit dhe ligjit mbi të drejtën e autorit.

Me respekt

Genc Jakupi _____

()

Deklaratë

Unë, Luljeta Adili-Çeliku, profesoreshë pranë Universitetit “Shën. Kirili dhe Metodi,- Shkup, Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare, deklaroj se e kam lektuar temën e magistraturës së kandidatit **Genc Jakupi** me titull: **Kontratat elektronike, sfidat dhe perspektivat e reja**, dhe për të njejtën mbaj përgjegjësi morale dhe juridike.

Prof. as. dr. Luljeta Adili-Çeliku

Përmbajtja

Qëllimet e hulumtimit.....	10
Hipotezat.....	11
Metodologjia e hulumtimit.....	12
Rëndësia e punimit.....	13
KAPITULLI I PARË.....	14
Kontratat në përgjithësi.....	14
1.1 Llojet e kontratave.....	15
1.2 Pozita e kontratave elektronike.....	17
1.3 Roli i kontratave elektronike.....	18
1.4 Zhvillimet teknologjike në raport me të drejtat pozitive të shteteve.....	19
1.5 Kontratat elektronike dhe përdorimi i tyre.....	21
KAPITULLI I DYTË.....	24
Përparësitë e kontratave elektronike.....	24
2.1 Përparësitë e kontratave elektronike në sferën juridike.....	26
2.2 Tejkalmimi i rrezikut tek kontratat elektronike.....	28
2.3 Kontratat elektronike, avancimet teknologjike në raport me të drejtat pozitive të shteteve... ..	30
2.4 Mangësitë dhe rreziqet e kontratave elektronike.....	31
2.5 Inteligjenca artificiale në raport me kontratat elektronike.....	34
KAPITULLI I TRETË.....	36
Forma si kusht i vlefshmërisë së kontratës me theks në RMV.....	36
3.1 Koha dhe vendi i lidhjes së kontratës.....	37
3.2 Kushtet e nevojshme për vlefshmërimin e kontratës të lidhur në rrugë elektronike.....	38
3.3 Rregullat për pranimin e kontratave elektronike (kontratat përmes postës elektronike dhe faqeve të internetit).....	40
3.4 Pranueshmëria dhe dëshmia e mesazhit.....	41
KAPITULLI I KATËRT.....	43
Kontrata elektronike në praktikë.....	43
4.1 Njohuritë, të drejtat dhe detyrimet e kontratave elektronike.....	44
4.2 Sfera e aplikimit në aspekt nacional dhe ndërkombëtar.....	45

4.2.1 Shtetet e zhvilluara në raport me kontratat elektronike	47
4.2.2 RMV-ja në raport me kontratat elektronike	48
4.2.3 Perspektivat e kontratave elektronike	53
4.2.4 Sfidat e përdorimit të kontratave elektronike në praktikë.....	54
4.3 Zhvillimet teknologjike dhe kontratat elektronike në raport me mjedisin jetësor	56
4.4 Kontratat elektronike dhe përshtatja e tyre në shoqëri.....	57
4.5 Raste studimi në shtete të ndryshme	59
4.6 Anketë	62
4.7 Konkluzione dhe rekomandime	65
Përfundimi	67
Literatura.....	69

Abstrakt

Ndikimi i zhvillimeve teknologjike në sferën juridike ka shënuar një progres të jashtëzakonshëm në nivel global. Kjo ka hapur një fushë të gjërë për përditësime ligjore dhe në të njëjtën kohë ka paraqitur sfida në përballjen e zbrazëtirave ligjore. Një nga zhvillimet kyçe në këtë kontekst është përdorimi i kontratave elektronike, një mjet që po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm dhe i përhapur. Në këtë punim, autori analizon kontratat elektronike, gjithashtu në punim jepen detajet lidhur me përdorimin e tyre, përparësitë dhe mangësitë e kontratave elektronike, dallimet me kontratat klasike, pozita e tyre ligjore në RMV, pozita e tyre në vende të ndryshme të botës, efektet e kontratave elektronike etj. Pjesë e veçantë në këtë punim i kushtohet pozitës së kontratave elektronike në të drejtat pozitive të shteteve të ndryshme. Gjithashtu, në punim, autori jep pikëpamjet e ndryshme lidhur me rregullimet ligjore, ndikimin dhe përshtatjen e tyre në shoqëri. Në bazë të hulumtimeve konkrete, në këtë punim arrihet një konkluzion rreth asaj se si pranohet përdorimi i kontratave elektronike në të drejtat e shteteve të ndryshme si dhe në shoqëri. Autori në këtë punim mbron tezën se kontratat elektronike kanë avantazh ndaj kontratave klasike dhe përdorimi i tyre në praktikë sjellë lehtësim dhe adaptim me zhvillimet e botës moderne.

Fjalët kyçe: kontratat elektronike, zhvillimet teknologjike, e drejta pozitive e shteteve, përparësitë kontratave elektronike.

Abstract

The impact of technological developments in the legal sphere has marked an extraordinary progress at the global level. This has opened a wide field for legal updates and at the same time has presented challenges in dealing with legal loopholes. One of the key developments in this context is the use of electronic contracts, a tool that is becoming increasingly important and widespread. In this paper, the author analyzes electronic contracts, the paper also provides details regarding their use, advantages and disadvantages of electronic contracts, differences with classic contracts, their legal position in the RNM, their position in different countries of the world, the effects of electronic contracts etc. A special part of this paper is devoted to the position of electronic contracts in the positive rights of different states. Also, in the paper, the author gives the

different views regarding the legal regulations, their impact and adaptation in society. Based on concrete research, in this paper a conclusion is reached about how the use of electronic contracts is accepted in the rights of different states as well as in society. The author in this paper defends the thesis that electronic contracts have an advantage over classic contracts and their use in practice brings relief and adaptation to the developments of the modern world.

Key words: electronic contracts, technological developments, positive law of states, advantages of electronic contracts.

Абстракт

Влијанието на технолошкиот развој во правната сфера бележи извонреден напредок на глобално ниво. Ова отвори широко поле за правни ажурирања и во исто време претставуваше предизвици во справувањето со правните дупки. Еден од клучните случувања во овој контекст е употребата на електронски договори, алатка која станува сè поважна и широко распространета. Во овој труд, авторот ги анализира електронските договори, во трудот се дадени и детали во однос на нивната употреба, предностите и недостатоците на електронските договори, разликите со класичните договори, нивната правна положба во РСМ, нивната позиција во различни земји во светот, ефектите од електронски договори итн. Посебен дел од овој труд е посветен на положбата на електронските договори во позитивните права на различните држави. Исто така, во трудот авторот ги дава различните ставови во однос на законските прописи, нивното влијание и адаптација во општеството. Врз основа на конкретни истражувања, во овој труд се доаѓа до заклучок за тоа како употребата на електронски договори е прифатена во правата на различни држави како и во општеството. Авторот во овој труд ја брани тезата дека електронските договори имаат предност во однос на класичните договори и нивната употреба во пракса носи олеснување и прилагодување на случувањата на современиот свет.

Клучни зборови: електронски договори, технолошки развој, позитивно право на државите, предности на електронските договори.

Hyrje

Avancimet në fushën teknologjike të shekullit XXI kanë ndryshuar rrjedhën e përditshme të veprimtarive tona në pothuajse të gjitha sferat e jetës. Këto ndryshime janë shoqëruar me sfida të ndryshme, përfshirë nevojën për të përshtatur sistemet tona ligjore dhe për të përdorur teknologjinë në përputhje me të mirën publike dhe nevojat e shoqërisë. Në këtë kontekst, një rol të rëndësishëm dhe me vlerë kanë kontratat elektronike, të cilat janë pasojë e këtyre avancimeve dhe janë përdorimi i tyre është vazhdimisht në rritje.

Në këtë kërkim, do të thellojmë shqyrtimin e çështjeve të ndryshme që lidhen me kontratat elektronike. Kjo përfshin dallimin midis tyre dhe kontratave të shkruara me dorë apo kontratave klasike, ndikimin e tyre në shoqërinë moderne, sfidat dhe rreziqet që mund të paraqiten, perspektivat dhe pozitën e tyre në kornizën e të drejtës positive si dhe çështje të tjera të kësaj natyre.

Për të bërë këtë, do të analizojmë se si kontratat elektronike janë përdorur deri më tani, si po ndikojnë në mënyrën e kryerjes së marrëveshjeve, çfarë kuptimi kanë në një botë gjithnjë e më të digjitalizuar, cilat janë përparësitë dhe mangësitë, si ndikojnë ato në të drejtat pozitive të shteteve ku këto kontrata gjejnë përdorim dhe shumë çështje të tjera me rëndësi për të kuptuar më shumë sa i përket kontratave elektronike.

Në kapitullin e parë të këtij punimi do të sqarojmë në përgjithësi për kontratat, digjitalizimin e shumë çështjeve që kanë rëndësi në sferën juridike, llojet e kontratave, në përgjithësi për kontratat elektronike dhe rolin e tyre, në kapitullin e dytë do të shqyrtojmë çështje të cilat kanë të bëjnë me përparësitë e kontratave elektronike, si në sferën juridike ashtu edhe në lehtësimin e shumë proceseve për të gjitha palët pjesëmarrëse në kontratat e tilla elektronike, ku do të flasim në detaje se cilat janë këto përparësi dhe si ato kanë ndikuar në të drejtat pozitive të shteteve në mbarë botën por edhe për ndikimin e tyre në jetën e përditshme në aspekt të përgjithshëm, në pjesën e dytë të kapitullit të dytë do të flasim për mangësitë dhe rreziqet potenciale të përdorimit të kontratave elektronike, besueshmërinë e tyre si dhe raportin e tyre me intelegjencën artificiale, ndërkaq në kapitullin e tretë do të flasim për vlefshmërinë e kontratës

elektronike me theks në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në fund në kapitullin e katërt do të flasim më në detaje për kontratat elektronike në praktikë, përdorimin e tyre në shtete të ndyshme, përdorimin e tyre në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe bëhet vërtetimi i hipotezës së parashtruar, paraqiten përfundime konkrete dhe jepen rekomandime që do të ndihmonin përdorimin e kontratave elektronike në mënyrë më të besueshme dhe më profitabile për palët pjesëmarrëse.

Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të analizojë kontratat elektronike në kontekstin e tyre kombëtar dhe ndërkombëtar, duke eksploruar përdorimin e tyre, avantazhet që ofrojnë kontratat elektronike, me një theks të veçantë në mënyrën se si ato përballen me zhvillimet e tjera teknologjike që kanë ndikim në aspektin juridik të kontratave.

Kontratat elektronike janë një fenomen i vazhdueshëm në botën e sotme, ku teknologjia është në zhvillim të vazhdueshëm. Për këtë arsye, është e rëndësishme të hulumtohet se si kontratat elektronike janë përdorur dhe përshtatur me kohën dhe çfarë roli kanë ato sot në nivel ndërkombëtar.

Në thelb, qëllimi i hulumtimit është pasqyrimi dhe analizimi se si kontratat elektronike kanë përmirësuar efikasitetin dhe sigurinë e marrëveshjeve juridike, duke përdorur teknologjinë për të zvogëluar mundësinë e gabimeve njerëzore dhe për të lehtësuar monitorimin e tyre në kohë reale. Gjithashtu, do të eksplorohet roli i tyre në përshtatjen me ndryshimet ligjore dhe në zgjidhjen e çështjeve ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, do të shqyrtohen edhe sfidat dhe mangësitë që mund të dalin me rastin e përdorimit të kontratave elektronike, siç janë siguria e të dhënave dhe mosmarrëveshjet ndërkombëtare. Përmes një analize të thellë të këtyre sfidave, synojmë të ofrojmë rekomandime për përmirësimin dhe avancimin e kontratave elektronike në të ardhmen.

Me qëllim që ky hulumtim të jetë sa më i dobishëm dhe i plotë, do të kemi një qasje që përfshin një gamë të gjerë burimesh dhe të dhënash nga burimet akademike, ligjore, dhe teknologjike. Për më tepër, do të ndodhë një krahasim midis përparësive dhe mangësive të kontratave elektronike në krahasim me metodat tradicionale të kontratës, duke përfshirë analizën e rasteve, të dhënat statistikore dhe komentet e ekspertëve në fushën e kontratave dhe teknologjisë informative. Ky hulumtim synon të krijojë një pamje të qartë dhe të detajuar mbi çështjet dhe sfidat që lidhen me kontratat elektronike në shekullin XXI si dhe perspektivën e tyre.

Hipotezat

Në këtë hulumtim synim kryesor është që në aspektin juridik të bëhet trajtimi i kontratave elektronike dhe të shihet gërshetimi i tyre me avancimet teknologjike të cilat vazhdimisht paraqesin sfidë për juridiksionin e shteteve dhe rritjen e rrezikut për paraqitjen e zbrazëtirave ligjore.

Hipotezat që parashtrihen:

Hipoteza e parë: Kontratat elektronike kanë avantazh ndaj kontratave klasike dhe përdorimi i tyre në praktikë sjellë lehtësim dhe adaptim me zhvillimet e botës moderne.

Hipoteza e dytë: Përparësitë e kontratave elektronike tejkalojnë rreziqet që mund të sjellin ato, mbrojtja dhe siguria kibernetike janë gjithmonë sfidë në rritje e të drejtave pozitive të të gjitha shteteve në botë.

Hipoteza e tretë: Avancimi i shtetit tonë në raport me shtetet e zhvilluara në sferën e risive juridiko- teknologjike gjithmonë merr shumë kohë për t'u adoptuar, kjo vë në pikëpyetje edhe përdorimin e përditshëm dhe efikas të kontratave elektronike.

Metodologjia e hulumtimit

Në këtë punim do të përdoren metodat si në vijim:

Metoda juridike, e cila ndihmon për përcaktimin e saktësisë së normës juridike, përmes caktimit të domethënies së drejtë të saj.

Metoda sociologjike, nëpërmjet të cilës tregohet për mënyrën dhe intensitetin e zbatimit të normës juridike në shoqëri.

Metoda historike. Aplikimi i kësaj metode synon krijimin e një pasqyre të ndryshimeve që kanë ndodhur lidhur me respektimin e të drejtës për jetë private dhe jetë familjare.

Metoda e analizës së legjislacionit. Përmes realizimit të metodës së analizës dhe të sintezës është bërë i mundur identifikimi i problemeve aktuale ligjore lidhur me respektimin e kësaj të drejte. Kjo metodë ka shërbyer edhe për analizimin e zbrazëtirave ligjore në legjislacionet nacionale, si dhe analizimin e atyre dispozitave që kanë kuptime të ndryshme, për të cilat paraqitet nevoja e interpretimit të tyre.

Metoda e studimit të rastit. Përmes studimit të rasteve, mendoj që arrijmë në përfundime më të drejta, sa i përket dhënies së mendimeve dhe propozimeve në lidhje me këtë temë.

Rëndësia e punimit

Përzgjedhja e kësaj teme është bërë me qëllim që të shtjellohen disa çështje të sferës juridike me theks tek kontratat elektronike përballë avancimeve teknologjike, gërshetimi i tyre, pozita ligjore e kontratave elektronike, zbatimi dhe roli i tyre, shembulli i shteteve të zhvilluara që përdorin ato në praktikë dhe ngecja tek shtetet në zhvillim.

Ky punim është i veçantë për nga rëndësia pasi që është një ndër punimet e para në gjuhën shqipe që i referohet kontratave elektronike. Pasi që zhvillimet e shumta teknologjike kanë vendosur në një sfidë të madhe legjislacionet e shteteve, është i nevojshëm studimi më i thellë avancimeve teknologjike në veçanti kontratave elektronike, pranueshmërinë e tyre në të drejtën pozitive të shteteve, zbatimin e tyre në praktikë, ndikimin e tyre dhe shumë çështje të tjera të kësaj natyre.

Si çështje kryesore që shtrohen për diskutim janë faktet se nëse këto zhvillime teknologjike dhe përdorimi i kontratave elektronike do të përmisojnë dhe lehtësojnë arritjen e marrëveshjeve mes palëve, do të dëmtojnë sistemin juridik të shteteve apo do të ndikojnë në zhvillimin dhe përditësimin e të drejtave pozitive të shteteve. Kalimi nga klasikja në modernen ka shënuar hapa gjigand në vitet e fundit dhe perceptimi i tyre nga spektri juridik më ka shtyrë që të bëj një punim të tillë, që nëpërmjet hulumtimit mbi kontratat elektronike të shohim edhe sfera të tjera të zhvillimeve teknologjike që ndikojnë në legjislacionin e shteteve dhe se si këto zhvillime shënojnë rritje të dinamikës së përdorimit, duke u nisur nga kjo vendosa që të shkruaj për temën e lartpërmendur me qëllimin që të arrijmë në përfundime të caktuara duke dhënë konkluzione dhe rekomandime.

KAPITULLI I PARË

Kontratat në përgjithësi

Me fjalën kontratë nënkuptojmë marrëveshje, për të cilën më së paku nevojiten dy palë dhe kjo marrëveshje ka peshën dhe vlerën e vet në varësi të mënyrës se si është lidhur mes palëve. Për ne me rëndësi janë trajtimi i kontratave në aspekt juridik, mënyra e lidhjes, palët si dhe të drejtat dhe obligimet që burojnë nga një kontratë e caktuar.

Në rradhë të parë në kontratën duhet ta trajtojmë si një marrëdhënie juridike ashtu që duhet të shohim se a është lidhur nga persona të cilët posedojnë të drejtën juridike për lidhje të kontratës, pastaj varësisht se cilës fushë të marrëdhënies juridike i përket duhet parë se a është në rregull në aspektin formal dhe në përputhshmëri me ligjet pozitive të shtetit apo shteteve tek të cilat ajo kontratë mund të prodhojë efekt juridik dhe shumë pika të tjera të cilat janë me rëndësi për vlefshmërinë juridike të kontratës.

Kontrata është marrëveshje e dy ose më shumë personave që kanë për qëllim të krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridiko obligative. Kjo do të thotë se me kontratë mund të krijohet një obligim, të ndryshohet një obligim dhe të shuhet një obligim. Kontrata është bazë mbi të cilën bazohet si qarkullimi i mbrendshëm i mallrave dhe shërbimeve ashtu edhe qarkullimi ndërkombëtar.¹

Përveç kuptimit në aspekt të përgjithshëm, sa i përket kontratave me rëndësi janë edhe shumë pika të tjera, duke përmendur këtu parimet kontraktore, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta, palët kontraktuese, kontratat me efekte dhe palë ndërkombëtare, veprimet juridike për lidhjen e saj, koha, vendi dhe mënyra e lidhjes së kontratës.

Parimet themelore që zbatohen tek kontratat konsiderohen: parimi i lirisë së kontraktimit dhe parimi i konsensualitetit.²

¹ Adnan Jashari, “E drejta afariste: (kontraktore)” fq. 30, Tetovë, 2016.

² Po aty, fq. 34

1.1 Llojet e kontratave

Për shkak të përcaktimit të qartë të zbatimit të rregullave kontraktore dhe studimit më të lehtë të tyre, do të bëjmë ndarjen e kontratave në bazë të kritereve të caktuara si;³

- a) *Sipas asaj se kontrata është e rregulluar me dispozita ligjore*, dallojmë; kontrata me emër dhe kontrata pa emër.⁴
- b) *Sipas kushteve të nevojshme për lidhjen e kontratës*, dallojmë; kontrata konsensuale dhe formale⁵
- c) *Sipas asaj se merr shpërblim(kundërvlerë) pala dhënëse apo jo*, dallojmë; kontrata me shpërblim(oneroze) dhe kontrata pa shpërblim(lucrative).⁶
- d) *Sipas të drejtave dhe detyrimeve që krijohen midis palëve kontraktuese*, dallojmë; kontrata të njëanshme detyruese dhe kontrata të dyanshme detyruese.⁷
- e) *Sipas asaj se palët kontraktuese në momentin e lidhjes së kontratës i di apo jo të drejtat dhe detyrimet e tyre*, dallojmë: kontrata kumulative dhe kontrata aleatore.⁸
- f) *Sipas kohëzgjatjes së prestimeve*, dallojmë: kontrata me prestime të përhershme dhe kontrata me prestime të përkohshme.⁹
- g) *Sipas asaj se a thua kontrata ka elemente të një kontrate apo të disa kontratave*, dallojmë: kontrata të thjeshta dhe të përziera.¹⁰
- h) *Sipas mënyrës së lidhjes*, dallojmë: kontrata të përgjithshme dhe kontrata të veçanta¹¹

³ Po aty fq. 62

⁴ Po aty

⁵ Po aty

⁶ Po aty fq. 63

⁷ Po aty

⁸ Po aty

⁹ Po aty

¹⁰ Po aty fq. 64

¹¹ Po aty

- i) *Sipas asaj se një kontratë a mund të ekzistojë pavarësisht nga kontratat tjera, dallojmë: kontrata të pavarura dhe kontrata aksesore.*¹²
- j) *Sipas asaj se a lidhet një kontratë me qëllim që të lidhet një kontratë tjetër; dallojmë: parakontratën dhe kontratën kryesore.*¹³
- k) *Sipas asaj se gjatë lidhjes së kontratës merren parasyshë cilësitë e veçanta të palëve kontraktuese apo jo, dallojmë: kontrata të thjeshta personale (intuit personae) dhe jo të thjeshta personale.*¹⁴
- l) *Sipas asaj se si shprehet vullneti gjatë lidhjes së kontratës, dallojmë: kontrata kolektive dhe individuale.*¹⁵
- m) *Sipas teknikës dhe mënyrës së lidhjes së kontratave, dallojmë: kontrata me përmbajtje të caktuar dhe kontrata të adezionit.*¹⁶
- n) *Sipas asaj se në kontratë a duket a jo baza, dallojmë: kontrata kauzale dhe abstrakte*¹⁷

Parakontrata obligon në qoftë se ka elemente esenciale të kontratës kryesore.¹⁸

Që kontrata të jetë e lejuar dhe e vlefshme ajo duhet të mos jetë e ndaluar.

Të ndaluara janë ato kontrata, të cilat janë në kundërshtim me dispozitat imperative, dhe rregullat e moralit shoqëror. Lidhja e kontratave të këtilla është kundër rendi të caktuar juridik dhe, sipas rregullës, kontratat e tilla janë të pavlefshme.¹⁹

¹² Po aty

¹³ Po aty

¹⁴ Po aty

¹⁵ Po aty fq. 65

¹⁶ Po aty

¹⁷ Po aty

¹⁸ Alajdin Alishani “Praktikumi nga e drejta e detyrimeve (Mendimet primore, Vendimet nga praktika gjyqësore dhe dispozitat ligjore)” fq. 78, Prishtinë, 1984.

¹⁹ Lubisha Millosheviq, “E drejta e detyrimeve (botimi i tretë)” fq. 83, Prishtinë, 1983

1.2 Pozita e kontratave elektronike

Kontratave elektronike në aspektin e përmbajtjes nuk dallojnë aspekt nga kontratat e rregullta, në fakt çdo kontratë e rregullt për të cilën dakordohen palët të caktuara, në rradhë të parë ka qenë kontratë e shkruar me anë të mjeteve apo pajisjeve teknologjike dhe e cila para se të shtypet ajo në parim ka qenë në një lloj mënyre kontratë elektronike, megjithatë fuqia juridike e tyre, efekti që prodhojnë ato si dhe pranueshmëria nga palët dhe e drejta pozitive e shteteve mund të dallojë.

Kontrata elektronike është ngushtë e lidhur me zhvillimet teknologjike të cilat kanë sjellë fundi i shekullit XX dhe fillimi i shekullit XXI, ashtu që për shumçka ka detyruar shtetet në mbarë botën që të jenë vazhdimisht në përpjekje për përditësime ligjore në këtë sferë që të mos ngelen zbrazëtira juridike të cilat do të mund të keqpërdoren për arsye të ndryshme e të cilat mund të sjellin shumë sfida në respektimin e ligjeve të një vendi.

Në thelb kontrata elektronike do të duhej të kuptohej si një kontratë e rregullt mes palëve por e cila nuk është e shtypur por është krijuar dhe nënshkruar përmes rrugëve elektronike dhe pajisjeve elektronike.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut vlen të theksohet se deri në një shkallë të caktuar kontratat elektronike gjejnë zbatim dhe të njëjtat kanë mbrojtje ligjore.

Kontrata lidhet kur palët kontraktuese janë marrë vesh për përbërjen thelbësore të kontratës.²⁰

Në ditët e sotshme pozita e kontratave elektronike është në kulminacionin e saj, pasi që në përditshmëri, përdorimi i pajisjeve elektronike na mundëson që të vendosemi para rasteve ku nevojitet autorizimi nga ana jonë që të kemi qasje në diçka të caktuar. Edhe kjo në vete është një lloj marrëveshje apo kontratë të cilën ne edhe pse nuk e nënshkruajmë, por thjesht duke pranuar atë të cilën na shfaqet në ekranet tona, ne i japim vlerën e një marrëveshjeje me palën tjetër.

²⁰ Neni 18, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për marrëdhënie detyrimore i RMV-së “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.161- 30.12.2009

Para se gjithash kontrata elektronike bën pjesë në kategorinë e dokumenteve elektronike dhe si e tillë trajtohet gjatë përdorimit dhe në kuptimin e mbrojtjes ligjore.

E-kontratat posedojnë potencialin për të ofruar efikasitet, kursim të kostos, zgjedhje në transaksion dhe automatizimin e lidhjes dhe miratimit të kontratës. Vlerat financiare, vlerat strategjike dhe vlerat e palëve të interesuara janë frytet e përgjithshme kategorike të kontratave elektronike.²¹

Dokumenti elektronik është çdo dokument i ruajtur në formë elektronike, veçanërisht regjistrime me tekst ose tingull, vizuale ose audio-vizuale.²²

1.3 Roli i kontratave elektronike

Për ne me interes është trajtimi në aspektin juridik i kontratave elektronike nga pikëpamja e zhvillimeve dinamike teknologjike dhe mundësisë së validitetit të një kontrate të caktuar përmes rrugëve elektronike, kjo çështje bën që rreziku të mos paraqitet vazhdimisht vetëm nga zhvillimet e lartpërmendura por edhe nga volumi i të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga ajo. Prandaj mund të themi se roli i kontratave elektronike është i jashtëzakonshëm, e kjo nënkupton se ajo në vete përveç anëve pozitive dhe thjeshtësimit të shumë çështjeve për palë të caktuara, në vete mbart edhe rreziqe të jashtëzakonshme, e të cilat kanë edhe pasoja juridike përpos pasojave të tjera.

Sot me anë kontratave të mençura dhe kontratave elektronike funksionon pothuajse çdo tregti e bërë përmes rrugëve elektronike respektivisht përmes përdorimit të internetit, kjo pasi që thjeshtëson ndjeshëm mënyrën e bërjes së tregtisë ndërmjet palëve.

Për shkak të përdorimit të madh të kontratave elektronike në mbarë botë, sot të gjitha shtetet dhe institucionet relevante ndërkombëtare kanë harmonizuar një sërë ligjesh me anë të së cilave

²¹ Enforceability of electronic contracts in light of the Ethiopian General Contract Law: appraising the issues.- <https://t.ly/fUkiH>

²² Neni 3, Ligji për Dokumentet elektronike, Identifikimet elektronike dhe Shërbimet Konfidenciale RMV “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.101/2019- 22.05.2019

bëhet mbrojtja e palëve pjesëmarrëse në kontratat e tilla, mbrojtja e të dhënave, siguria kibernetike në këtë drejtim si dhe validiteti i këtyre kontratave.

Kontrata elektronike u mundëson palëve që në mënyrë shumë të shpejtë të komunikojnë dhe të arrijnë deri tek një marrëveshje e caktuar, gjë e cila nuk do të ishte e mundur pa zhvillimet teknologjike dhe përdorimin e internetit, si pasojë kjo ka ndihmuar bizneset e ndryshme në shtete të ndryshme që të kenë përfitime që dikur nuk kanë qenë të mundshme, si dhe horizonti se ku mund të shtrijnë fushën e veprimit këta palë është shumë më i gjërë se sa ka qenë dikur dhe e gjithë kjo nënkupton se përfitues në këtë rast janë të gjithë palët, përfshirë këtu edhe shtetet, bizneset e të cilave kanë arritur që përmes shfrytëzimit të kontratës elektronike të përfitojnë dhe kjo përkthehet në përfitime edhe për shtetet përmes pagesës së taksave dhe tatimeve të përcaktuara me ligj.

Një ndër rolet më të rëndësishme të kontratave elektronike është thjeshtësimi dhe benefiti që ajo ofron për bizneset në raport me klientin dhe bizneset tjera si palë.

Kur një biznes përdor kontratat elektronike (e-kontratatë) në mënyrën e duhur, ato mund të ndihmojnë në përmirësimin e përvojës së klientit, thjeshtimin e transaksioneve dhe rritjen e efikasitetit. Por është e rëndësishme të kuptohen mënyrat e ndryshme se si mund të krijohen dhe zbatohen këto kontrata, në mënyrë që të minimizohet rreziku dhe të rriten përfitimet.²³

Roli i kontratave elektronike është shumë i gjërë, përdorimi i të cilave nuk do të kishte peshën që ka sot po të mos kishte mbrojtjen juridike, sepse nuk do të mund të arrinin tek kontratat elektronike pa mos pasur bindjen se ne jemi të mbrojtur nga organet relevante.

1.4 Zhvillimet teknologjike në raport me të drejtat pozitive të shteteve

Dallimet midis dokumenteve si leter dhe atyre virtuale janë megjithatë mjaft interesante dhe mbështesin disa propozime të reja për rregullimin e kontratës në formë standarde. Megjithatë, këto perspektiva të reja përshtaten mirë me ligjin ekzistues të kontratës kornizë sepse struktura bazë

²³ <https://rb.gy/r2u1m>, marrë me 16.06.2023

dhe ekonomia themelore e transaksionit të formës standarde janë të qëndrueshme si në botën e letrës ashtu edhe në atë elektronike.²⁴

Ashtu siç kemi përmendur deri më tani, kontratat elektronike janë ngushtë të lidhura me zhvillimet teknologjike, pa këto zhvillime nuk do të ishte e mundur të ekzistonin dhe të përdreshin kontrata elektronike.

Me kalimin e kohës është e domosdoshme që të ndodhë përditësimi nga ana e legjislacioneve të shteteve që të u bëjnë ballë këtyre zhvillimeve teknologjike.

Edhe këto zhvillime kanë kaluar në etapa të ndryshme dhe kanë prodhuar efekte të mëdha në të drejtat pozitive të të gjitha shteteve në mbarë botën, ashtu që shtetet më të fuqishme kanë qenë të parat që kanë ndërmarrë hapa konkret që ligjet e tyre të përshtaten me këto zhvillime teknologjike, kurse shumë shtete të tjera më pas kanë ndjekur të njëjtin shembull.

Sot ndoshta më shumë se kurrë kemi dinamikë në aspektin e zhvillimeve teknologjike, Vlen të përmendim zhvillimet në aspektin e intelegjencës artificiale e cila llogaritet si problematike më e madhe njerëzore, kjo pasi që avancimet në atë drejtim janë shumë të shpejta dhe pothuajse çdo fushë është e prekur nga këto zhvillime.

Zhvillimet e tilla teknologjike supozohet të thjeshtësojnë dhe të ndihmojnë jetën e përditshme të njerëzve, por po që se nuk do të kishte mbrojtje ligjore dhe rregulla të caktuara, kjo do të sillte komplikime dhe probleme të cilat do të vështirësonin jetën e njerëzve.

Prandaj, shtetet dhe ligjvënësit janë duke punuar që gjatë gjithë kohës të jenë në hap me kohën në drejtim të përditësimit të ligjeve të cilat synojnë të u bëjnë ballë keqpërdorimeve dhe zbrazëtirave ligjore që mund të vijnë si pasojë e zhvillimeve të tilla teknologjike. Mbrojtja ligjore ndërkombëtare është domosdoshmëri për këto zhvillime teknologjike, prandaj Këshilli i Europës është në hartim të një konvente ndërkombëtare sa i përket intelegjencës artificiale me fokus tek të drejtat e njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë.

²⁴ Hillman, Robert A. and Rachlinski, Jeffrey John, Standard-Form Contracting in the Electronic Age. Fq. 5. <https://ssrn.com/abstract=287819> or <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.287819>

Sfida më e madhe e ligjvënësve është që këto zhvillime të mos keqpërdoren, siç ka qenë deri më tani por deri në një shkallë të caktuar vazhdon të jetë edhe më tej çështja e monedhave elektronike respektivisht kripto valutave, të cilat për vite me rradhë kanë qenë pothuajse totalisht të pa kontrolluara në aspektin ligjor dhe është fakt që ato janë përdorur në masë të madhe për kryerjen e një numri të veprimtarive të ndaluara, por për arsye se kjo çështje paraqiste risi në historinë njerëzore, shumë persona shmangën dënimin pasi që nuk ishte paraparë një ligj që do të ndëshkonte veprimet e tilla, ku vlen të theksohet që edhe ditët e sotshme ekzistojnë shumë hapësira që përmes kripto valutave të shmangët përgjegjësia penale, si pasojë ligjvënësit në mbarë botën ndodhen në një situatë e cila është shumë e ndërlikuar për zgjidhje ligjore të shpejtë, e në ndërkohë përdoren ligjet ekzistuese për të kontrolluar këtë situatë.

1.5 Kontratat elektronike dhe përdorimi i tyre

Një kontratë, në term të përgjithshëm, mund të përkufizohet si një marrëveshje ligjore dhe e detyrueshme midis dy ose më shumë palëve, në të cilën palët angazhohen të përmbushin disa detyrime me qëllim marrjen e të drejtave të caktuara në këmbim.²⁵

Që nga kohërat e lashta, kontratat janë përdorur për të zyrtarizuar lloje të ndryshme marrëdhëniesh, veçanërisht ato që lidhen me biznesin dhe tregtinë. Në epokën aktuale të informacionit dhe teknologjisë, kombinohen bizneset dhe tregtitë tradicionale me teknologjitë më të fundit. Si pasojë, po lindin modele dhe metoda të reja biznesi, të cilat përdorin intensivisht rrjetet e komunikimit dhe teknologjitë e tjera.²⁶

Kontratat elektronike prfshijnë një përdorim të gjërë gjithandej, në fusha të ndryshme dhe për çështje të ndryshme mes palëve. Ato janë të pranuar ndërkombëtarisht dhe kanë vlerë juridike, megjithatë varësisht se për çfarë kontrate bëhet fjalë, mund të ndryshojë apo të paraqiten dyshime mbi vlefshmërinë juridike të saj, në mesin e të cilave ka nga ato kontrata të cilat nuk kanë vlerë në

²⁵ Perez, Maria. "Electronic Contracting for Inter-Enterprise Collaboration." Thesis, Blekinge Tekniska Högskola, Avdelningen för interaktion och systemdesign, 2008, fq. 9. <http://urn.kb.se/resolve?urn=urn:nbn:se:bth-1249>.

²⁶ Po aty

organe të caktuara apo institucione të caktuara në rast se nuk janë të formës klasike të shtypur dhe të nënshkruar nga palët, apo edhe vulat përkatëse varësisht nga kontrata.

Një kontratë nuk do t'i mohohet vlefshmëria ose zbatueshmëria vetëm me arsyetimin se ajo është në të formën e një komunikimi elektronik.²⁷

Është më e lirë të negociosh dhe të hartosh një marrëveshje përmes internetit sesa me stilolaps dhe letër sepse mesazhet elektronike transmetohen në çast, poashtu është e formës me shkrim, e lehtë për t'u kopjuar dhe shpërndarë, e lirë për t'u ruajtur dhe riprodhuar dhe e aksesueshme nëpërmjet harduerit tashmë i disponueshëm nga kompjuteri dhe modemi, duke shmangur kështu nevojën për pajisje të specializuara si faks ose teleks.²⁸

Në konventën e kombeve të bashkuara mbi përdorimin e komunikimit elektronik dhe kontratave ndërkombëtare, flitet për komunikimin elektronik se si ndikon dhe ndihmon në arritjen e një marrëveshjeje mes palëve që shpeshherë përkthehet në përfitime të caktuara mes këtyre palëve, ashtu që tregohet për terme të ndryshme dhe mënyra të caktuara të komunikimit elektronik, për të cilat do të flasim në vazhdim.

Për t'u theksuar është fakti se përdorimi i kontratave elektronike në bazë të përdorimit të tyre aktual dhe lehtësimeve që sjell, do të shënojë rritje në mënyrë të vazhdueshme, ashtu që duke parë digjitalizimin e shumë gjërave në përditshmërinë tonë, mund të thuhet se kontratat klasike do Megjithëse E-Marrëveshja mund të përdoret në marrëdhëniet midis biznesit dhe konsumatorëve, ajo nuk përfshin asnjë dispozitë që lidhet me mbrojtjen e konsumatorit. Ligji për mbrojtjen e konsumatorit është zakonisht i detyrueshëm dhe në shumicën e rasteve ligji i kombëtar dhe ai lokal për mbrojtjen e konsumatorit do të aplikohet kur një konsumator përfundon një transaksion. Bizneset që dëshirojnë të përdorin E-Marrëveshjen për të hyrë në marrëdhëniet kontraktuale me

²⁷ Polanski, Paul Przemyslaw, "Convention on E-Contracting: The Rise of International Law of Electronic Commerce?" (2006). BLED 2006 Proceedings. 20. <https://aisel.aisnet.org/bled2006/20>

²⁸ Shawn Pompian, 'Is the Statute of Frauds Ready for Electronic Contracting?' (1999) 85(7) Virginia LR 1447 marrë me 22.07.2023

konsumatorët duhet, prandaj, të njohin nevojën për përputhshmëri me ligjet kombëtare dhe lokale të mbrojtjes së konsumatorit.²⁹

²⁹ Rekomandimi Nr. 31 nga edicioni i parë, i miratuar nga Qendra e Kombeve të Bashkuara për Lehtësimin e Tregtisë dhe Biznesit Elektronik (UN/CEFACT), Gjenevë, maj 2000 nën referencën e dokumentit ECE/TRADE/257, fq. 2

KAPITYLLI I DYTË

Përparësitë e kontratave elektronike

Kontratat elektronike janë një instrument juridik i rëndësishëm në kohën tonë të digjitalizuar, ata janë dokumente që përfshijnë marrëveshje, të dhëna, dhe detyrime të ndërmjetësuara elektronikisht në vend të dokumenteve të shkruara me dorë.

Këto kontrata nuk kanë ndikim vetëm në aspekt juridik por edhe në shumë aspekte dhe fusha të tjera, ndër të cilat më e rëndësishmja është fusha e tregtisë.

Një nga zhvillimet e shpejta në fushën e tregtisë është tregtia elektronike duke përdorur kontratat elektronike, të cilat ofrojnë komoditet dhe i lejojnë njerëzit të bëjnë transaksione të shpejta pa qenë të kufizuara nga hapësira dhe kufijtë kohorë. tregtia elektronike është një formë e tregtisë që ka karakterin e vet, përkatësisht tregtia që kalon rajonet dhe madje edhe kufijtë kombëtarë, takimi i blerësve dhe shitësve nuk realizohet, bëhet kudo dhe kurdo, duke përdorur internetin. Ky kusht nga njëra anë është shumë i dobishëm për konsumatorët, sepse ata kanë shumë zgjedhje për të marrë mallra dhe nuk kanë nevojë të lëvizin nga vendbanimi i tyre, por nga ana tjetër shkeljet e të drejtave të konsumatorit janë shumë të rrezikshme për shkak të karakteristikave dalluese të e-tregtisë.³⁰

Përparësitë e kontratave elektronike janë të shumta nga të cilat mund të përmendim:

- 1) *Efikasitet dhe shpejtësi*: Kontratat elektronike përmirësojnë ndjeshëm shpejtësinë e procesit të nënshkrimit dhe ekzekutimit të kontratave. Ata mund të nënshkruhen dhe të dërgohen në kohë shumë të shpejtë, duke evituar nevojën për të dërguar dokumentet me anë të postës që do të thotë se kontratat elektronike kanë përparësi të jashtëzakonshme në këtë aspekt në krahasim me kontratat që nuk janë të formës elektronike.

³⁰ Ilmih, Andi Aina, and A. Zulkarnain. "IDEAL ELECTRONIC CONTRACT MODEL AS A FORM OF E-COMMERCE DISPUTES SETTLEMENT." *Jurnal Pembaharuan Hukum* 6, no. 1 (March 6, 2019): fq. 77. <http://dx.doi.org/10.26532/jph.v6i1.4463>.

- 2) *Aksesim i lehtë*: Kontratat elektronike lejojnë aksesim të lehtë dhe të shpejtë për pjesëmarrësit në këto kontrata, përfshirë nënshkruesit dhe të interesuarit e tjerë, që mund të kenë nevojë të shikojnë ose të verifikojnë dokumentacionin në të ardhmen.
- 3) *Mbajtja e regjistrave*: Përparësia e mbajtjes së regjistrave të kontratave elektronike është e konsiderueshme. Të gjitha kopjet dhe ndryshimet e kontratës ruhen elektronikisht, duke lehtësuar përcjelljen dhe kërkimin e ndryshimeve si dhe të dhënave të dërguara.
- 4) *Ruajtja e mjedisit*: Kontratat elektronike janë një alternativë e shkëlqyeshme në aspektin e mbrojtjes së mjedisit për dallim ndaj dokumenteve të shtypura, të cilat kërkojnë shfrytëzim të bimëve dhe energjisë për prodhimin dhe dërgimin e tyre.
- 5) *Siguria dhe integriteti*: Platformat e kontratave elektronike ofrojnë masa të sigurisë për të parandaluar manipulimin ose ndryshimin e dokumenteve pa leje, duke përfshirë nënshkrimet digjitale dhe çertifikatat e sigurisë.
- 6) *Lehtësia e nënshkrimit*: Nënshkrimi elektronik i kontratave është bërë i lehtë dhe i sigurtë përmes teknologjive të përparuara të autentifikimit të cilat ju ofrojnë palëve mundësinë që shumë shpejtë dhe lehtë të vendosin nënshkrimin e tyre në dokumentet e caktuara. “Nënshkrimi elektronik” nënkupton një tingull, simbol ose proces elektronik të bashkangjitur ose të lidhur logjikisht me një dokument dhe të ekzekutuar, ose të adoptuar nga një person me qëllim të nënshkrimit të dokumentit.³¹
- 7) *Ndjekja dhe monitorimi*: Kontratat elektronike mund të monitorohen më lehtë për detyrimet dhe afatet e tyre, duke lejuar ndjekjen për ekzekutimin e tyre dhe duke lehtësuar ndryshimet e nevojshme.
- 8) *Ndërveprimi*: Kontratat elektronike mund të ndërveprojnë lehtë me sistemet e tjera të menaxhimit të informacionit dhe të financave, duke përmirësuar kështu integrimin e të dhënave.

³¹ The hybrid smart contract agreement challenge to European electronic signature regulation. - <https://t.ly/aLY1v>

- 9) *Kosto më e ulët*: Përdorimi i kontratave elektronike zakonisht çon në uljen e kostove të stampës, dërgesës me postë, dhe administrimit të dokumentacionit fizik.³²

Përparimet e tilla në afat të caktuar kohor mund të çojnë zhvillimet teknologjike që shumë shpejt dhe në mënyrë efikase, duke përdorur aplikacione të caktuara në mënyrë të menjëhershme të bëjnë detektimin se a është në përputhje me ligjin një çështje e caktuar dhe e është e shënuar në marrëveshjen mes palëve pjesëmarrëse.

2.1 Përparësitë e kontratave elektronike në sferën juridike

Kontratave elektronike ofrojnë shumë përparësi në sferën juridike, duke sjellë ndryshime të rëndësishme dhe ndihmuese në mënyrën se si marrëveshjet dhe detyrimet legale trajtohen dhe zbatohen. Këtu do të ndalemi tek disa nga përparësitë kryesore të kontratave elektronike në sferën juridike:

- 1) *Legaliteti*: Në shumicën e juridiksioneve, kontratat elektronike janë të ligjshme dhe të njohura juridikisht, ndryshe nga disa vite më parë, kur ishin të konsideruara më pak të besueshme. Kjo do të thotë që ato kanë të njëjtën vlerë legale si kontratat e hartuara me dorë.
- 2) *Nënshkrimi elektronik*: Kontratave elektronike përdorin nënshkrimet elektronike të besueshme, të cilat janë të njohura juridikisht dhe ofrojnë të njëjtin nivel të sigurisë si nënshkrimet me dorë. Kjo përmirëson procedurat për nënshkrim dhe lejon palët të nënshkruajnë kontratat pa mos qenë fizikisht në të njëjtin vend me palët e tjera. edhe një emër në fund të postës elektronike (e-mail) konsiderohet si nënshkrim elektronik.³³

³² <https://rb.gy/n4f5b>, marrë me 14.08.2023

³³ Liisi Ju'rgen, Die elektronische Signatur nach europä'ischem, deutschem und estnischem Recht (Westfälische Wilhelms-Universität Münster 2015) fq. 14.

- 3) *Integriteti dhe siguria*: Kontratat elektronike përdorin teknologji të sigurisë, duke përfshirë enkriptimin për të garantuar integritetin dhe konfidencialitetin e dokumentave, gjë e cila redukton rrezikun e ndryshimit të të dhënave pa lejen e palëve.
- 4) *Historiku dhe monitorimi*: Kontratat elektronike ruajnë historikun në mënyrë të detajuar të çdo ndryshimi dhe aktiviteti të kryer në dokument, duke lejuar ndjekjen dhe monitorimin e të gjitha veprimeve të kryera në lidhje me kontratën, ashtu që nëse do të tentohej që në ndonjë mënyrë të bëhet një ndërhyrje në një kontratë të caktuar, kjo do të lejonte që pala tjetër të vendoset në dijeni për një ndërhyrje të tillë.
- 5) *Aksesimi i lehtë*: Kontratat elektronike janë të lehtësisht të aksesueshme për të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë avokatët dhe gjyqtarët. Kjo lejon në përshpejtimin e procesit kur paraqitet kontest ligjor.
- 6) *Përdorimi i teknologjisë*: Kontratat elektronike përdorin teknologji të avancuar për të adresuar shkeljet e detyrimeve. Automatizimi i çështjeve të tilla bën të mundur zbatimin e afateve dhe identifikimin e shkeljeve.
- 7) *Mbrojtja e të dhënave*: Përdorimi i sistemeve të avancuara të sigurisë mundëson mbrojtjen e të dhënave të përfshira në kontrata. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në raste kur kontratat përfshijnë të dhëna personale, të dhëna të kompanisë apo të dhëna të tjera me rëndësi.
- 8) *Mundësia e thjeshtësimi të kërkesave*: Përdorimi i platformave të menaxhimit të kontratave elektronike lejon lehtësimin e kërkesave për informacion dhe dokumentacion në raste të kontesteve juridike. Kjo përmirëson transparencën dhe zvogëlon koston dhe kohën e procedurave ligjore.

Nga e gjithë kjo mund të themi se kontratat elektronike kanë bërë një ndryshim të ndjeshëm në mënyrën se si marrëveshjet juridike trajtohen dhe implementohen. Ato sjellin përparësi të shumta në sigurinë, efikasitetin dhe efektivitetin e procesit të kontratave dhe janë një mjet i rëndësishëm për avokatët, ushtruesit e tjerë të profesioneve që kanë të bëjnë me kontrata,

institucionet dhe organizatat që dëshirojnë të përmirësojnë mënyrën se si ata menaxhojnë marrëveshjet legale.

2.2 Tejkalmi i rrezikut tek kontratat elektronike

Tejkalmi i rreziqeve tek kontratat elektronike është një sfidë e rëndësishme për organizatat dhe individët që përdorin këtë metodë të nënshkrimit dhe menaxhimit të kontratave. Këtu janë disa nga mënyrat se si mund të tejkalohen rreziqet kryesore të kontratave elektronike:

- a) *Siguria e të dhënave*: Për të parandaluar keqpërdorimet dhe aksesin e paligjshëm në të dhënat e kontratave, duhet pasur parasyshë përdorimin e platformave të sigurta dhe të cilat ofrojnë politika të forta të sigurisë, përdorimi i teknologjive të enkriptimit dhe për monitorimin e aksesit të të dhënave janë praktika të rëndësishme.
- b) *Autentifikimi i nënshkrimeve*: Kjo është një ndër pikat më të rëndësishme dhe më të ndjeshme pasi që përdorimi i nënshkrimeve elektronike të besueshme është rrezik i madh për sigurinë e kontratave. Këto nënshkrime duhet të jenë të sigurta dhe të vërtetuara që të garantohet identiteti i palëve të nënshkrimit, kurse nga ana tjetër të mos lejohet zbrazëtitje e tillë që më pas palët të justifikohen se nuk kanë nënshkruar personalisht ata ose kanë qenë nën kërcënim apo presion të caktuar.
- c) *Politika të kujdesit të të dhënave*: Organizatat, institucionet dhe persona të tjerë juridik duhet të kenë politika dhe procedura që i referohen kujdesit të të dhënave me të cilat do të garantohej mbrojtja e të dhënave të palëve, klientëve apo palëve pjesëmarrëse dhe nënshkruese në përgjithësi. Këto politika duhet të jenë në përputhshmëri me ligjet ekzistuese por me rëndësi është zbatimi rigoroz i këtyre politikave pasi që dëmi që mund të shkaktohet nga lëshimet në këtë sferë janë tepër të kushtueshme si në aspektin financiar për palën që bën një lëshim të tillë dhe palën e dëmtuar poashtu edhe në aspektin legal, ku mund të ketë dënime të rënda në përputhje me ligjin.

- d) *Ndjekja dhe monitorimi i kontratave*: Përdorimi i platformave të menaxhimit të kontratave mund të ndihmojë në monitorimin e afateve kohore dhe detyrimeve të kontratave. Kjo ndihmon në parandalimin e shkeljeve të kontratës dhe rikujton për detyrimet që kanë palët ndaj njëra-tjetrës.
- e) *Edukimi dhe trajnimi*: Duhet pasur parasyshë që personeli dhe palët e interesuara të kenë njohuri të mjaftueshme për përdorimin e kontratave elektronike dhe rregullat e sigurisë, trajnimet dhe edukimet në këtë sferë mund të parandalojnë gabime dhe rreziqe të panevojshme.
- f) *Rikuperimi*: Ruajtja e kopjeve të sigurta të kontratave elektronike dhe të të dhënave është e rëndësishme për rikuperim në rast të humbjes së të dhënave ose dokumenteve të caktuara, prandaj përdorimi i programeve apo pajisjeve të caktuara elektronike është i domosdoshëm, kjo ngase ato do të mundësonin rikuperimin në rast të humbjes, fshirjes apo diçka e ngjajshme që do të mund të ndodhë me pajisjen apo vendin ku dokumentet dhe kontratat elektronike arkivohen.
- g) *Përputhshmëria ligjore*: Është e patjetërshesuhme që kontratat elektronike të përputhen me ligjet dhe rregulloret e vendit në të cilat ato gjejnë zbatim dhe prodhojnë efekte të caktuar mes palëve.
- h) *Konsultimi i juristëve*: Në raste komplekse ose kur ka dyshime për përshtatshmërinë e një kontrate elektronike, është e këshillueshme konsultimi me një jurist ose avokat për të siguruar që të gjitha aspektet legale janë të rregulluara duke mos lënë hapësirë për gabime të kësaj natyre, por vlen të theksohet se edhe jurisiti që konsultohet për çështje të tilla duhet të ketë njohuritë adekuate për kontratat elektronike.

Për të përcaktuar juridiksionin e një mosmarrëveshjeje ndërmjet palëve në juridiksione të ndryshme, rregullat e së drejtës ndërkombëtare private kanë përdorur tradicionalisht gjeografinë

ose vendndodhjen e palëve ose vendin ku aktivitetet tregtare zhvillohen si faktorë fiks që lidhin palët, kontrata e tyre ose mosmarrëveshja e tyre në një juridiksion të caktuar.³⁴

Duke i theksuar dhe i adresuar këto rreziqe, organizatat dhe individët mund të përfitojnë plotësisht nga përparësitë e kontratave elektronike dhe të sigurojnë integritetin dhe sigurinë e të dhënave dhe marrëveshjeve të tyre.

2.3 Kontratat elektronike, avancimet teknologjike në raport me të drejtat pozitive të shteteve

Kontratat elektronike dhe avancimet teknologjike kanë pasur një ndikim të thellë në sferën juridike dhe kanë ndihmuar në ndryshimin e dinamikës së të drejtave pozitive të shteteve.

Deri tek një kontratë elektronike në ditët e sotshme arrihet në mënyrë shumë të lehtë. Çdo pajisje që zotëron një kapacitet për të komunikuar informacion kur lidhet me internetin ose rrjetet e ndërmjetësuara nga kompjuteri mund të destinohet për kontrata elektronike.³⁵

Kontratat elektronike kanë sjellë një nivel të ri të efikasitetit në procesin e krijimit dhe zbatimin e marrëveshjeve juridike, duke lejuar për automatizimin e disa proceseve dhe eliminimin e shumë ndërveprimeve që mernin shumë kohë të gjatë dhe të panevojshme. Kjo ka thelluar ndjeshëm aftësinë për të zbatuar marrëveshjet në mënyrë efikase dhe të shpejtë. Avancimet teknologjike kanë ndihmuar në rritjen e drejtësisë dhe transparencës në procesin ligjor, duke sjellë mundësinë për monitorimin dhe vlerësimin më të lehtë të veprimeve dhe vendimeve ligjore.

Kontratat elektronike kanë hapur diskutimet për mënyrat se si duhet të mbrohen të dhënat personale në marrëveshjet elektronike, duke krijuar nevojën për përmirësimin dhe përshtatjen e legjislacionit për privatësinë dhe sigurinë e të dhënave në këtë kontekst të ri teknologjik.

³⁴ The hybrid smart contract agreement challenge to European electronic signature regulation.- <https://rb.gy/k5qil>

³⁵ Enforceability of electronic contracts in light of the Ethiopian General Contract Law: appraising the issues.- <https://rb.gy/uozog>

Zhvillimet e shpejta teknologjike dhe globalizimi kanë sjellë sfida të reja për mbrojtjen e të dhënave personale. Shkalla e mbledhjes dhe ndarjes së të dhënave personale është rritur ndjeshëm. Teknologjia lejon që të dhënat personale të përpunohen në një shkallë të paprecedentë për të ndjekur aktivitete të tilla si parandalimi, hetimi, zbulimi ose ndjekja penale e veprave penale ose ekzekutimi i dënimeve penale.³⁶

Parimet dhe rregullat për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale, pavarësisht nga kombësia ose vendbanimi i tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë e tyre themelore, në veçanti të drejtën e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo direktivë synon të kontribuojë në arritjen e një zone të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.³⁷

Si përfundim i kësaj mund të themi se kontratat elektronike dhe avancimet teknologjike kanë ndikuar në mënyrë të thellë në sferën juridike dhe janë një fushë e rëndësishme e hulumtimit. Këto zhvillime sjellin sfida dhe mundësi të reja në mënyrën se si ligjet dhe drejtësia trajtohen dhe implementohen në një mjedis gjithnjë e më të digjitalizuar.

2.4 Mangësitë dhe rreziqet e kontratave elektronike

Rritja e përdorimit të kontratave elektronike dhe avancimet teknologjike në këtë drejtim kanë sjellë përparësi dhe njëkohësisht rreziqe të reja, kjo sepse me anë të këtyre kontratave vendosen në qarkullim të drejta dhe detyrime që shpeshherë nënkuptojnë qarkullim dhe përfitime monetare për palët, e kjo tërheq vëmendjen e atyre që duan ilegalisht të përfitojnë përmes tyre, të cilët duke përdorur mënyra dhe zbrazëtira të ndryshme që të vendosin në lajthitje apo të mashtrojnë palët.

³⁶ Paragrafi 3, Direktiva (BE) 2016/680 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 27 prill 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale ose ekzekutimit të dënimeve penale, dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin Vendimi Kornizë i Këshillit 2008/977/JHA

³⁷ Po aty, paragrafi 2

E gjithë kjo bën që të paraqitet rreziqe të natyrave të ndryshme të cilat patjetër duhet të merren në konsideratë nga palët pjesëmarrëse në këto kontrata, e që vlen të theksohet se bota në të cilën jetojmë sot e bën pothuajse të pamundur që ne të mos të jemi palë të ndonjë kontrate të formës elektronike.

Mangësitë e kontratave elektronike

- a) *Mungesa e nënshkrimit fizik*: Në krahasim me kontratat e nënshkruara me dorë, kontratat elektronike nuk kanë një nënshkrim fizik, që mund të sjellë dyshime në disa raste mbi autenticitetin dhe vullnetin e palëve.
- b) *Dështimi teknologjik*: Dështimet teknologjike, përfshirë ndërprerjet e rrjetit dhe humbjen e të dhënave, mund të çojnë në humbjen e informacionit të kontratave dhe të dhënave të tjera të rëndësishme.
- c) *Privatësia dhe siguria*: Ekzistojnë shqetësime që lidhen me sigurinë dhe privatësinë e të dhënave në kontratat elektronike. Rreziku i piratimit dhe aksesit të paligjshëm është i pranishëm dhe bën që besimi tek kontratat elektronike të mos jetë në nivelin e duhur.
- d) *Barriera teknologjike*: Edhe pse jetojmë në një botë tejet të digjitalizuar, në të jetojmë edhe njerëz të gjeneratave të cilët e kanë pothuajse të pamundur të kenë njohuri të mjaftueshme për botën teknologjike prandaj themi se në disa raste, palët mund të kenë kufizime teknologjike që pengojnë përdorimin e kontratave elektronike. Për shembull, ndonjëra prej palëve mund të mos ketë akses në internet ose pajisje të nevojshme me rëndësi për realizimin e veprimeve të caktuara në botën digjitale.

Rreziqet e kontratave elektronike

Kur bëhet fjalë për nënshkrimin e kontratave në mënyrë elektronike, siguria është një shqetësim i madh për të dyja palët. Pa masat e duhura të sigurisë, kontrata mund të rrezikohet të ndryshohet, vidhet apo edhe shkatërrohet. Për të garantuar sigurinë e kontratave online, është e rëndësishme të merren masat e duhura për të mbrojtur dokumentet elektronike. Këto masa

përfshijnë përdorimin e kriptimit të fortë, serverëve të sigurt, nënshkrimeve digjitale dhe protokolleve të vërtetimit.³⁸

- a) *Nënshkrimi i paligjshëm*: Për më tepër, siguria dhe autenticiteti mund të rrezikohen, pasi nënshkrimet elektronike mund të jenë të cenueshme ndaj mashtrimit, falsifikimit ose manipulimit dhe mund të mos ofrojnë prova të mjaftueshme të identitetit dhe autoritetit të nënshkruesit ose integritetit dhe autenticitetit të dokumentit.³⁹
- b) *Manipulimi i të dhënave*: Kontratat elektronike mund të jenë të prekura nga ndryshime të paligjshme ose manipulime të të dhënave. Siguria dhe kontrolli i të dhënave janë shqetësime të rëndësishme, kjo ngase pale të treta përmes piratimit mund të arrijnë deri në pikën që të manipulojnë me të dhëna sidomos në rastet kur kontratat elektronike nuk kanë sigurinë e duhur teknologjike përmes programeve adekuate.
- c) *Mospërputhshmëria ligjore*: Kontratat elektronike duhet të përputhen me ligjet dhe rregulloret e vendit në të cilën ato prodhojnë efekt juridik. Mungesa e një kornize ligjore të qartë mund të sjellë konflikte ligjore, ashtu që më pas palët të shfrytëzojnë këtë si pretekst për mosrespektimin e kontratës dhe si përfundim kontrata të shpallet e pavlefshme juridikisht.
- d) *Problemet e përkthimit*: Në rastin e kontratave elektronike ndërkombëtare, mund të ketë vështirësi në përkthimin e kontratave dhe në kuptimin e plotë të detyrimeve, megjithatë kjo nuk dallon shumë nga rreziku i njëjtë që përkthimi paraqet edhe për kontratat klasike, megjithatë edhe kjo bën pjesë në kategorinë e rreziqeve sepse duke tentuar që dokumentet e caktuara të përkthehen në mënyrë vetanake dhe jo përmes profesionistëve mund të bëjë që kontratat të merr kuptim tjetër e më pas të paraqiten vështirësi dhe pamundësi për respektimin e të njëjtës.
- e) *Mungesa e ndihmës ligjore*: Në disa raste, palët mund të mos kenë dijeni të mjaftueshme dhe si rezultat të mos kuptojnë plotësisht pasojat e kontratave elektronike. Kjo mund të

³⁸ <https://rb.gy/swfcu>, marrë me 02.09.2023

³⁹ <https://rb.gy/z5zii>, marrë me 08.09.2023

çojë në marrjen e vendimeve të papërgjegjshme dhe prodhimin e pasojave të padëshiruara juridike për palën pjesëmarrëse në këto lloj kontratash.

Për të tejkaluar këto mangësi dhe rreziqe, është e rëndësishme të respektohen rregullat dhe standardet e caktuara të sigurisë, të përdoren teknologji të caktuara që e mundësojnë një gjë të tillë por edhe të bëhen përpjekje për të marrë këshillën e një eksperti të fushës kur është e nevojshme. Kontratat elektronike janë një mjet i fuqishëm, por duhet të trajtohen me kujdes për të evituar pasojat negative.

2.5 Inteligjenca artificiale në raport me kontratat elektronike

Inteligjenca artificiale (IA) është një komponent kyç në ndryshimet dhe përparimet e fundit në fushën e kontratave elektronike. IA-ja përdoret për të përmirësuar, automatizuar dhe avancuar proceset e krijimit, menaxhimit dhe ekzekutimit të kontratave elektronike. Këtu janë disa mënyra se si IA-ja ka një ndikim pozitiv në kontratat elektronike:

1. *Automatizimi i proceseve*: IA-ja mund të përdoret për të automatizuar shumicën e proceseve të krijimit të kontratave. Kjo përfshin identifikimin e modeleve të përsëritura në kontratat ekzistuese, duke krijuar kontrata të reja bazuar në modelet ekzistuese dhe duke ngarkuar të dhënat në kontratat elektronike në mënyrë automatike.
2. *Analiza e tekstit*: IA-ja ka aftësinë për të analizuar dhe kuptuar tekstin në kontratat elektronike. Kjo mund të përdoret për të zbuluar detyrime, afate dhe kushte të rëndësishme, duke bërë që kërkimi dhe monitorimi i kontratave të jetë më efikas.
3. *Siguria dhe verifikimi i identitetit*: IA-ja përdoret për të siguruar sigurinë e nënshkrimeve elektronike dhe për të verifikuar identitetin e palëve. Për shembull, sistemet e njohjes së fytyrës dhe të identitetit përdoren për të bindur se personi që nënshkruan është ai që thotë që është.

4. *Ndjekja dhe monitorimi i kontratave:* IA-ja ka një efekt të thellë në praktikën e ligjit. Megjithëse AI-ja ka më shumë gjasa të ndihmojë sesa të zëvendësojë avokatët në një afat të shkurtër, ajo tashmë po përdoret për të rishikuar kontratat, për të gjetur dokumente përkatëse në procesin e zbulimit dhe për të kryer kërkime ligjore. Kohët e fundit, IA-ja ka filluar të përdoret për të ndihmuar në hartimin e kontratave, parashikimin e rezultateve ligjore dhe madje rekomandimin e vendimeve gjyqësore në lidhje me dënimin ose lirimin me kusht.⁴⁰
5. *Parashikimi i konflikteve dhe rreziqeve:* IA-ja mund të identifikojë konfliktet potenciale dhe rreziqet në kontratat elektronike duke analizuar të dhënat dhe kushtet. Ky është një mjet i rëndësishëm për menaxhimin e rreziqeve.⁴¹
6. *Optimizimi i marrëdhënieve kontraktuale:* IA-ja ndihmon në optimizimin e marrëdhënieve kontraktuale duke ofruar informacionin dhe analizën e nevojshme për të ndërmarrë veprime të menaxhueshme në kohë reale.
7. *Përmirësimi i përgjithshëm i efikasitetit:* Përdorimi i IA-së në procesin e kontratave elektronike rrit efikasitetin, redukton kostot dhe zvogëlon gabimet njerëzore sidomos të natyrës teknike dhe gjuhësore.

Megjithatë, është e rëndësishme të kemi parasyshë sfidat dhe rreziqet që mund të paraqiten me përdorimin e IA-së në kontratat elektronike, si siguria e të dhënave dhe mbingarkesa teknologjike. Për më tepër, duhet të kemi një kornizë ligjore dhe rregulla të qartë për përdorimin e IA-së në këtë kontekst.

⁴⁰ <https://rb.gy/chj7p>, marrë me 07.09.2023

⁴¹ <https://rb.gy/3kkd5>, marrë me 04.09.2023

KAPITULLI I TRETË

Forma si kusht i vlefshmërisë së kontratës me theks në RMV

Në numrin më të madh të legjislacioneve, si rregull i përgjithshëm, pranohet se kontrata lidhet kur palët kanë rënë dakord për elementët e saj. Ky është një rast kur nuk kërkohen formalitete të veçanta në lidhje me përfundimin e tij. Në literaturën juridike janë të shumta rastet nga të cilat mund të konstatohet se në numrin më të madh të sistemeve juridike mbizotëron mendimi për vlefshmërinë e kontratës edhe kur ajo është lidhur gojarisht. Përkatësisht, vlefshmëria e kontratës nuk kërkon një formë të veçantë përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.⁴²

Gjithsesi, kur nevojitet forma e posaçme (e shkruar) për të vlerësuar vlefshmërinë e një kontrate, lind pyetja se a duhet të pranohet si e vlefshme një kontratë e lidhur elektronikisht në parim. Kjo dilemë ka lindur për shkak të kufizimeve të aplikimit të komunikimeve elektronike gjatë procesit të lidhjes së kontratave, veçanërisht në fillimet e periudhës kur kompjuterët filluan të përdoren për aktivitetet komerciale. Kjo çështje bëhet edhe më komplekse në rastet kur ligjet vendore kërkojnë një procedurë të caktuar ose një formë të veçantë për lidhjen e kontratës.

Në situatat kur rregulloret kombëtare kërkojnë një formë të caktuar në lidhje me lidhjen e kontratës atëherë për të njejtën me qëllim të pastrimit të dilemave i referohemi Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore të RMV- së ku thuhet se: “Kërkesa në formë të shkruar plotësohet edhe kur palët shkëmbejnë letra ose do të bien dakord me anë të disa mjeteve të komunikimit të cilat ju lejon të përcaktoni me siguri ekzistencën dhe përmbajtjen e deklaratës, si dhe identitetin e personit që e jep atë”.⁴³

"Kur ligji kërkon që informacioni të jepet me shkrim, mesazhi e plotëson atë kusht nëse informacioni i përfshirë në të është në dispozicion për t'u përdorur në referencat e mëvonshme".⁴⁴

⁴² Мирослав Андоновски, Љупче Маркушески, Игор Здравкоски, Електронското склучување на договорите во развојот на електронската трговија <https://www.researchgate.net/publication/>

⁴³ Neni 64 paragrafi 4, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për marrëdhënie detyrimore i RMV-së “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.161- 30.12.2009

⁴⁴ Neni 6 paragrafi 1, Ligji Model i UNCITRAL-it për Tregtinë Elektronike, me udhëzues për miratim, 1996: Me nenin shtesë 5 SHIB (BIS) të miratuar në 1998

Duke u nisur nga këto parime, ligjvënësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut e ka harmonizuar legjislacionin e tij me këto dispozita, ku thuhet se:

“Kontratat mund të lidhen në mënyrë elektronike, përkatësisht në formë elektronike. Oferta dhe pranimi i ofertës mund të bëhet në mënyrë elektronike, pra në formë elektronike”.⁴⁵

3.1 Koha dhe vendi i lidhjes së kontratës

Çështjet që lidhen me kohën dhe vendin e lidhjes së kontratës janë elementë shumë të rëndësishëm për çdo kontratë kur ajo lidhet. Momenti kur konsiderohet e lidhur një kontratë është i rëndësishëm sepse ai moment shoqërohet shpesh me çështjen e kalimit të pronësisë mbi sendin dhe kalimin e rrezikut të humbjes ose dëmtimit të objektit të kontratës. Rëndësia e vendit ku është lidhur kontrata mund të jetë e rëndësishme sepse nga ai vend mund të varet zbatimi i ligjit kompetent dhe procedura për zgjidhjen e kontestit.

Për sa i përket kohës dhe vendit të dërgimit dhe marrjes së mesazhit (këtu nënkuptojmë lidhjen elektronike të kontratave) modeli i Ligjit UNCITRAL për Tregtinë Elektronike në nenin 15 përcakton "Përveç rastit kur është rënë dakord ndryshe midis autorit dhe marrësit, mesazhi konsiderohet se është dërguar në momentin kur ka hyrë në sistemin e informacionit që është jashtë kontrollit të autorit ose personit që dërgon mesazhin në emër të autorit".⁴⁶

Në të njëjtin nen lidhur me vendin ndër të tjera thuhet "...mesazhi konsiderohet se është dërguar në vendin ku ka selinë e porositësit dhe konsiderohet se është marrë në vendin ku marrësi ka selinë e biznesit".⁴⁷

⁴⁵ Neni 10 paragrafi 1 dhe 2, Ligji për Tregti Elektronike i RMV-së "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.133- 02.11.2007

⁴⁶ Neni 15 paragrafi 1, Ligji Model i UNCITRAL-it për Tregtinë Elektronike, me udhëzues për miratim, 1996: Me nenin shtesë 5 SHIB (BIS) të miratuar në 1998

⁴⁷ Po aty, paragrafi 4

Këtyre çështjeve vëmendje i ka kushtuar edhe Ligji për Marrëdhëniet Detyrimore i RMV-së sipas të cilit “kontrata lidhet në momentin kur ofertuesi merr deklaratën nga i ofertuari. se ai e pranon ofertën”.⁴⁸

Për sa i përket lidhjes elektronike të kontratave sipas legjislacionit kombëtar, zgjidhja për të njëjtën gjë gjendet në Ligjin për Tregtinë Elektronike sipas të cilit “kontrata në formë elektronike konsiderohet e lidhur në momentin kur ofruesi merr mesazh elektronik i cili përmban një deklaratë të marrësit se e pranon përmbajtjen e kontratës. Oferta dhe pranimi i ofertës konsiderohet se janë marrë kur janë në dispozicion të palëve të cilave u drejtohen (që do të thotë se këtu pranohet edhe pozicioni që nuk ka rëndësi nëse marrësi e hap postën, sa shpesh ai e bën këtë, nëse ai mungon etj., është e rëndësishme që mesazhi të jetë i disponueshëm për të). Konsiderohet se kontrata është lidhur në vendin ku ofertuesi ka pasur selinë ose vendbanimin në momentin që ka bërë ofertën”.⁴⁹

3.2 Kushtet e nevojshme për vlefshmërimin e kontratës të lidhur në rrugë elektronike

Sot kontratat në tregti (kryesisht elektronike) nuk kanë mënyrën klasike të lidhjes në shumicën e rasteve. Duke marrë parasysh tendencat moderne të biznesit që lejojnë tregtinë moderne të zhvillohet me një shpejtësi të jashtëzakonshme, disa faza të pazareve klasike, për shembull negociatat e gjata, përjashtohen dhe në vend të tyre përdoren gjerësisht kontratat standarde (të standardizuara) ose faqet WEB të studentëve. në tregti. Gjithashtu, jo rrallëherë në fund të kontratës figuron një dispozitë “shih kushtet e kontratës bashkangjitur” ose “kushtet e përgjithshme të publikuara në Fletoren Zyrtare janë të vlefshme dhe do të zbatohen” etj.⁵⁰

Lidhur me lidhjen elektronike të kontratave me mjete elektronike, sugjerohet që shtetet anëtare me legjislacionin e tyre të sigurojnë që kontratat të lidhen në mënyrë elektronike. Shtetet

⁴⁸ Neni 23, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për marrëdhënie detyrimore i RMV-së “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.161- 30.12.2009

⁴⁹ Neni 14 paragrafi 1 dhe 2, Ligji për Tregti Elektronike i RMV-së “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.133- 02.11.2007

⁵⁰ Мирослав Андоновски, Љупче Маркушески, Игор Здравкоски, Електронското склучување на договорите во развојот на електронската трговија <https://www.researchgate.net/publication/>

anëtare duhet të sigurojnë në mënyrë specifike që kushtet ligjore të kërkuara për procesin kontraktual të mos pengojnë përdorimin efikas të kontratave elektronike dhe as të kontribuojnë që kontrata të tilla të privohen nga efekti dhe vlefshmëria e tyre juridike vetëm për shkak se ato janë lidhur në mënyrë elektronike.

Shteteve anëtare u lihet mundësia të parashikojnë që dispozitat e mëparshme nuk do të zbatohen për:

- Kontratat që kërkojnë vërtetim nga noteri;
- Marrëveshjet që, për shkak të nevojës për vlefshmërinë e tyre, duhet të regjistrohen pranë autoriteteve publike;
- Marrëveshjet për të cilat zbatohen rregulloret e së drejtës familjare;
- Kontratat që referohen nga rregulloret për tatimin në trashëgimi;⁵¹

“Në lidhje me lidhjen e kontratës, vetëm nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, oferta dhe pranimi i ofertës mund të bëhet me mesazh. Kur një mesazh përdoret në lidhjen e një kontrate, një kontratë e tillë nuk do të privohet nga vlefshmëria ose zbatueshmëria e saj thjesht për shkak të faktit se një mesazh përdoret për këtë qëllim.”⁵²

Republika e Maqedonisë së Veriut, si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ndjek vendimet e organeve të Unionit, kështu që këtë çështje e ka rregulluar në legjislacionin e saj, ndërsa dispozitat që kanë të bëjnë me lidhjen elektronike të kontratave nuk do të zbatohen. (neni 10, paragrafi 5 nga Ligji për Tregti Elektronike) për kontratat “të rregulluara me rregulloret për familjen dhe trashëgiminë; të cilat krijojnë dhe transferojnë të drejta mbi pasuritë e paluajtshme, me përjashtim të së drejtës së qirasë; për të cilat, sipas ligjit, kërkohet përfshirja e gjykatave, noterëve ose profesioneve të ngjashme pas një garancie të dhënë dhe për siguri shtesë, nga persona që veprojnë për qëllime jashtë angazhimit të tyre tregtar, të punës ose profesional”.⁵³

⁵¹ Po aty.

⁵² Neni 11, paragrafi 1, Ligji Model i UNCITRAL-it për Tregtinë Elektronike, me udhëzues për miratim, 1996: Me nenin shtesë 5 SHIB (BIS) të miratuar në 1998

⁵³ Neni 10 paragrafi 5, Ligji për Tregti Elektronike i RMV-së “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.133- 02.11.2007

3.3 Rregullat për pranimin e kontratave elektronike (kontratat përmes postës elektronike dhe faqeve të internetit)

Elementet themelore të një kontrate të vlefshme janë oferta, pranimi dhe konsiderata. Përpara shfaqjes së kontratave online, kontrata tradicionale bëhej me gojë ose me shkrim në letër. Në kontratat tradicionale, oferta dhe pranimi zakonisht komunikohen me letra të dërguara me postë. Prandaj, rregulli postar rregullon formimin e një kontrate tradicionale. Në këtë rregull komunikimi i një oferte është i plotë kur bëhet fjalë për dijeninë e ofertuesit dhe pranimi është i plotë kundrejt ofertuesit kur letra është postuar. Domethënë, pranimi është efektiv dhe i plotë në momentin që letra është postuar. nëse propozuesi ka marrë apo jo letrën e pranimit. Kjo është krijuar për të parandaluar që propozuesi të ndryshojë mendjen e tij/saj pas postimit të pranimit, por para se të merret.⁵⁴

Kur oferta dërgohet me postë elektronike duhet theksuar se kjo metodë nuk është e menjëhershme, sepse shkruhet mesazhi, klikohet "dërgo" dhe më pas kompjuteri kërkon në bazën e të dhënave të tij për të gjetur personin të cilit i dërgohet mesazhi. Me fjalë të tjera, kjo situatë është e ngjashme me atë kur një letër dërgohet me postë. Nga pikëpamja juridike, pyetja themelore është nëse pranimi i ofertës u bë i vlefshëm kur u dërgua mesazhi apo kur u mor. Meqenëse dërguesi nuk do të jetë i sigurt se kur është bërë, gjykatat kanë marrë qëndrimin se është më mirë të zëvendësohet koha më e hershme, që nënkupton momentin kur është dërguar (dërguar) mesazhi. Prandaj, nëse palët në kontratë, pra marrëveshja, nuk parasheh ndryshe, vendi i dërgimit të kontratës do të konsiderohet vendi i ofertuesit, jo vendi i serverit të tij dhe sigurisht jo vendi i të ofertuarit.⁵⁵

Me rastin e përcaktimit të afatit të saktë për marrjen e mesazhit, sipas mendimit të shumë autorëve, gjykatat me shumë gjasa do të vendosin për teorinë e pranimit. Sipas këtij kuptimi,

⁵⁴ Jalil, Md Abdul, and Leo D. Pointon. "Developments in electronic contract laws." *Computer Law & Security Review* 20, no. 2 (March 2004): fq. 117. [http://dx.doi.org/10.1016/s0267-3649\(04\)00020-2](http://dx.doi.org/10.1016/s0267-3649(04)00020-2).

⁵⁵ Мирослав Андоновски, Љупче Маркушески, Игор Здравкоски, Електронското склучување на договорите во развојот на електронската трговија <https://www.researchgate.net/publication/>

pranimi i mesazheve zakonisht prodhon një veprim kur ofruesi lexon mesazhin nga rrjeti, sepse mund të pritët që më pas të lexojë mesazhin që i dërgohet nga serveri.⁵⁶

Bëhet fjalë një marrëveshje digjiitale ku përdoruesit bien dakord me kushtet e kontratës duke klikuar një buton ose duke shënuar një kuti që thotë "Unë jam dakord". Kontratat klikmbështjellëse përdoren kryesisht për faqet e regjistrimit dhe faqet e hyrjes. Ato gjithashtu përdoren zakonisht përpara se përdoruesit të shkarkojnë përmbajtje ose aplikacione softuerike, të blejnë ose të përdorin një faqe interneti.⁵⁷

3.4 Pranueshmëria dhe dëshmia e mesazhit

Në zhvillimin e tregtisë elektronike ka një rol shumë të rëndësishëm çështja e pranueshmërisë dhe fuqisë provuese të mesazheve elektronike në proceset gjyqësore dhe administrative, pra edhe të kontratave të lidhura në mënyrë elektronike. Ndërsa rregullat në disa juridiksione janë fleksibile në këtë drejtim, ka sisteme ligjore që kanë rregulla shumë strikte dhe specifike që përjashtojnë mesazhet elektronike si provë në rast mosmarrëveshjeje. Studimet që janë bërë në organizatat ndërkombëtare që merren me çështjet e tregtisë elektronike konsiderojnë se çështja e fuqisë evidentuese të mesazhit elektronik është një pengesë e madhe për zhvillimin e tregtisë elektronike në përgjithësi.

Në lidhje me mesazhet që dërgohen elektronikisht përmes një kompjuteri, një nga kundërshtimet më domethënëse ka të bëjë me mundësinë që të dhëna të tilla të përdoren si provë në rast mosmarrëveshjeje. Numri më i madh i legjislacioneve kombëtare (rregulloret procedurale) nuk përmbajnë dispozita me të cilat kjo metodë e provës mund të përdoret si ligjërishit e rëndësishme. Prandaj, shumë avokatë kërkuar që kjo çështje të shqyrtohet sa më shpejt që të jetë e mundur, sepse një numër i madh transaksionesh biznesore mund të vihen në pikëpyetje dhe palët kontraktuese do të pësojnë nëse nuk janë në gjendje të paraqesin prova me shkrim në gjykatë, siç

⁵⁶ M. Chissick, *Electronic Commerce – Law and Practice*. London 1999, fq.73.

⁵⁷ <https://rb.gy/vxloo>, marrë me 18.06.2023

kërkohet nga shteti. Prandaj, nuk është e pazakontë që Ligji Model i UNCITRAL-it (neni 9) trajtoi çështjen e forcës juridike të informacionit që përmbajnë kompjuterët. Lidhur me këtë, theksohet se: “në çdo procedurë ligjore nuk do të zbatohet asgjë në lidhje me rregullat e procedurës që do të nënkuptonte mohimin e pranueshmërisë së mesazhit si provë”.⁵⁸

"Besueshmëria e mënyrës së gjenerimit, ruajtjes ose dërgimit të mesazhit, besueshmëria e mënyrës se si është ruajtur integriteti, mënyra se si është identifikuar autori i tij, si dhe çdo fakt tjetër relevant" do të jenë. marrë parasysh".⁵⁹

⁵⁸ Мирослав Андоновски, Љупче Маркушески, Игор Здравкоски, Електронското склучување на договорите во развојот на електронската трговија <https://www.researchgate.net/publication/>

⁵⁹ Neni 9 paragrafi 2, Ligji Model i UNCITRAL-it për Tregtinë Elektronike, me udhëzues për miratim, 1996: Me nenin shtesë 5 SHIB (BIS) të miratuar në 1998

KAPITULLI I KATËRT

Kontrata elektronike në praktikë

Kontratat elektronike janë një realitet në përdorimin e përditshëm të biznesit dhe të individëve. Ato janë shumë të përdorura në praktikë për shkak të shumë përparësive që ofrojnë. Këtu janë disa shembuj se si kontratat elektronike përdoren në praktikë:

- *Blerja dhe shitja në rrjet (“online”)*: Një shembull i zakonshëm është procesi i blerjes dhe shitjes në rrjet. Kur bëhet blerje e një produkt në internet, zakonisht pranohet kontrata elektronike duke klikuar në një kuti që tregon se kemi lexuar dhe pranuar kushtet dhe shërbimet e shitësit. Kjo kontratë përcakton çmimin, kushtet e kthimit, dhe të gjitha informacionet e tjera të rëndësishme.
- *Shërbimet e abonimit*: Shumë shërbime në rrjet, si platformat e transmetimit të videove apo aplikacionet e muzikës, përdorin kontratat elektronike për të vendosur kushtet e abonimit. Përdoruesit pranojnë këto kushte kur regjistrohen për shërbimin dhe bëjnë pagesat mujore ose vjetore.
- *Aplikacionet e kredisë dhe kreditet online*: Kur bëhet aplikimi për një kartë krediti në internet, procesi përfshin pranimin e një kontrate elektronike. Kjo kontratë përcakton normat e interesit, detyrimet dhe kushtet e pagesës.
- *Kontratat e punës online*: Edhe kontratat e punës janë bërë gjithnjë e më të zakonshme të nënshkruhen elektronikisht. Puna në distancë dhe puna nga larg kërkojnë shpesh që të nënshkruhen kontratat në mënyrë elektronike.
- *Kontratat e sigurimeve*: Siguruesit përdorin kontratat elektronike për të ofruar policat e sigurimeve të ndryshme. Përdoruesit mund të nënshkruajnë dhe të paguajnë për këto sigurime në internet.

- *Ndërmarrjet dhe partneritetet biznesi me biznes (B2B)*: Kontratat elektronike janë të zakonshme në marrëdhëniet biznes me biznes. Për shembull, një kompani mund të nënshkruajë një kontratë elektronike me një furnizues për të siguruar mallra ose shërbime në mënyrë të vazhdueshme.
- *Dokumentacioni juridik dhe noterimi elektronik*: Në disa juridiksione, dokumentacioni juridik, përfshirë testamentet dhe akte të pronësisë, mund të noterohet elektronikisht. Kjo lejon për një proces më të lehtë dhe të shpejtë në rast të nevojës për të konfirmuar dokumentacionin zyrtar.

Këto janë vetëm disa shembuj të mënyrave se si kontratat elektronike përdoren në praktikë. Ata kanë bërë proceset më të lehta dhe më efikase në shumë fusha të ndryshme të biznesit dhe jetës së përditshme.

4.1 Njohuritë, të drejtat dhe detyrimet e kontratave elektronike

Njohuritë mbi përdorimin e kontratave elektronike janë të rëndësishme për të kuptuar se si ato funksionojnë dhe se si palët mund të shërbehen me këto kontrata. Rëndësia e njohurive qëndron në faktin se këto kontrata në vete mbartin rreziqe të sferave të ndryshme të cilat i kemi përmendur deri më tani.

Kontratat elektronike janë më të popullarizuara se kurrë më parë. Bota e biznesit po bëhet gjithnjë e më digjitale, veçanërisht në epokën post- Covid.⁶⁰

Të drejtat dhe detyrimet mbi kontratat elektronike janë tejet të rëndësishme për të kuptuar si funksionojnë, si i mbrojnë të interesuarit dhe si shërbejnë në praktikë. Të drejtat dhe detyrimet e kontratave elektronike në thelb nuk dallojnë nga të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga kontratat klasike, megjithatë ne mund të përmedim disa të drejta dhe detyrime kryesore:

⁶⁰ <https://rb.gy/rkuus> marrë me 13.07.2023

Te drejtat e palës që pranon kontratën elektronike: E drejta për informim, e drejta për të refuzuar, e drejta për të nënshkruar, e drejta për të negociuar, e drejta për të ndryshuar mendimin etj.

Detyrimet e palës që pranon kontratën elektronike: detyrimi për ta lexuar kontratën, detyrimi për të pranuar kushtet, detyrimi për të respektuar detyrimet, detyrimi për të komunikuar mbi ndryshimet, detyrimi për të mos e vënë në rrezik zbatimin e kontratës etj.

4.2 Sfera e aplikimit në aspekt nacional dhe ndërkombëtar

Kontratat elektronike përfshijnë një sferë të gjerë të aplikimit, që prek edhe aspektin nacional edhe atë ndërkombëtar.

Niveli nacional:

1. *Legjislacioni vendor- specifik*: Shumica e vendeve kanë ligje të veçanta që rregullojnë kontratat elektronike në nivel nacional. Këto ligje vendore përcaktojnë rregullat dhe standardet që duhet të ndiqen për të cilat një kontratë elektronike mund të konsiderohet ligjore. Prandaj, është e rëndësishme të njihet legjislacionin vendor specifik i vendit ku lidhet kontrata elektronike.
2. *Këshillat juridike*: Në nivel vendor është gjithashtu e rëndësishme të kërkohen këshilla juridike të specializuara në përputhshmëri me ligjin sa i përket kontratave elektronike në vendin ku ato prodhojnë efekt juridik. Jursitët e specializuar në këtë drejtim mund të ndihmojnë që palët të kuptojnë zbatimin e rregullave vendore për kontratat elektronike, por mes tjerash duhet theksuar se edhe juristët duhet të kenë dijeni në këtë drejtim.
3. *Marrëdhënia me palën tjetër*: Në nivel nacional ashtu sikurse edhe për kontratat klasike, por edhe me më tepër vëmendje tek kontratat elektronike është e rëndësishme të ketë një marrëdhënie të qartë me palën tjetër në lidhje me kontratën. Kjo përfshinë komunikimin

dhe pranimin e të drejtave dhe detyrimeve të kontratës në mënyrë të qartë dhe të njohur nga të dyja palët.

Niveli ndërkombëtar:

Një kontratë cilësohet si ndërkombëtare kur përfshin një element të huaj, në kuptimin që mund të konsiderohet lidhja e saj me të drejtën e disa shteteve.⁶¹

1. *Konventat ndërkombëtare*: Në nivel ndërkombëtar, ka disa konventa dhe marrëveshje ndërkombëtare që kanë për qëllim të harmonizojnë rregullat dhe standardet për kontratat elektronike. Për shembull, ndër më bazike që mund të përmendim është Konventa e OKB-së për Kontratat Ndërkombëtare për Mallrat (CISG) e cila ka dispozita që përcaktojnë aplikimin e kontratave elektronike në transaksionet ndërkombëtare të mallrave.
2. *Respektimi i juridiksioneve vendore- specifik*: Në rastet e transaksioneve ndërkombëtare, është e rëndësishme të respektohen ligjet dhe rregulloret e vendit nga ku realizohet blerja, merrja e mallrave ose shërbimeve. Përveç kësaj, është e rëndësishme të përcaktohet juridiksioni i aplikueshëm në çdo kontratë elektronike në mënyrë të qartë.
3. *Përdorimi i platformave të sigurta dhe të besueshme*: Për transaksione ndërkombëtare të kontratave elektronike, është e rëndësishme të përdoren platforma të sigurta dhe të besueshme që ndjekin standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe integritetit të kontratave.
4. *Arbitrazhi ndërkombëtar*: Në rast të mosmarrëveshjeve të mundshme ndërkombëtare, mund të jetë e dobishme të parashihet një klauzolë arbitrazhi në kontratë, që përcakton mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve përtej gjykatave vendase.

⁶¹ Edderouassi, Meryem. "Le contrat électronique International." Thesis, Université Grenoble Alpes (ComUE), 2017, fq. 31. <http://www.theses.fr/2017GREAD009/document>.

Kontrata elektronike ndërkombëtare mbulojnë një spektër shumë të gjerë aktivitetesh. Meqenëse këto përbëjnë, në përgjithësi, marrëveshje vullneti me synimin për të krijuar një marrëdhënie detyrimi, mund të ketë një shumëllojshmëri pothuajse të pafundme kontratash.⁶²

Në përfundim, aplikimi i kontratave elektronike në aspektin nacional dhe ndërkombëtar kërkon njohuri të kujdesshme të legjislacionit vendor- specifik dhe të rregullave ndërkombëtare, si dhe një kujdes të veçantë ndaj sigurisë dhe mbrojtjes së të drejtave të palëve të kontratës. Për këtë arsye, është e rekomandueshme të kërkohen këshillë juridike.

4.2.1 Shtetet e zhvilluara në raport me kontratat elektronike

Shtetet e zhvilluara kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të promovuar dhe rregulluar kontratat elektronike në mënyrë që të përmirësojnë efikasitetin dhe sigurinë e transaksioneve në mjedisin digjital.

Shumica e shteteve të zhvilluara kanë miratuar ligje dhe rregulla specifike që përcaktojnë kushtet dhe rregullat e kontratave elektronike. Këto ligje dhe rregulla ndihmojnë në sigurimin e qartësisë dhe sigurisë së kontratave elektronike.

Në përgjithësi shtetet në botë zbatojnë parimin se një kontratë nuk mund të mos konsiderohet si e paligjshme vetëm se është lidhur në mënyrë elektronike.

“Regjimi ligjor i zbatueshëm për procesin kontraktor nuk pengon përdorimin e kontratave elektronike dhe nuk çon në heqjen e efektit juridik dhe vlefshmërisë së kontratave të tilla për arsye se ato janë lidhur në mënyrë elektronike”.⁶³

Disa shtete të zhvilluara kanë vendosur sisteme të noterimit elektronik që lejojnë konfirmimin dhe verifikimin e kontratave elektronike nga një noter zyrtar. Ky proces siguron integritetin dhe validitetin e kontratave.

⁶² Ch. LARROUMET, « Droit civil : Les obligations, Le contrat, 1ère partie : Conditions de formation », t. III, 6ème Ed. ECONOMICA 2007, fq. 152.

⁶³ Neni 9 i Direktivës Nr. 2000/31/KE për tregtinë elektronike

Shumica e shteteve të zhvilluara kanë krijuar agjenci dhe institucione përgjegjëse për mbikqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe rregullave që lidhen me kontratat elektronike. Këto agjencione ofrojnë këshilla dhe udhëzime për palët që përdorin kontratat elektronike.

Shtetet e zhvilluara promovojnë përdorimin e kontratave elektronike në mënyrë aktive përmes fushatave të informacionit dhe mbështetjes për organizatat dhe individët. Kjo përfshin shpërndarjen e informacionit mbi përfitimet dhe praktikën më të mirë të kontratave elektronike.

Kontratat elektronike janë duke u përdorur në sfera të ndryshme të ekonomisë dhe shoqërisë, duke përfshirë bizneset, sektorin financiar, sektorin shëndetësorë dhe shumë të tjera. Kjo ka rritur efikasitetin dhe transparencën në këto sektore.

Shtetet e zhvilluara janë gjithashtu të angazhuara në përdorimin e kontratave elektronike për të ulur ndikimin e tyre mjedisor. Përdorimi më i ulët i letrës dhe burimeve të tjera natyrore është një përparësi mjedisore e kësaj teknologjie.

Në përfundim mund të themi se shtetet e zhvilluara janë në krye të promovimit dhe rregullimit të kontratave elektronike për të siguruar qartësinë, sigurinë dhe efikasitetin e transaksioneve në botën digjitale. Këto hapa kanë bërë që përdorimi i kontratave elektronike të jetë një praktikë e pranuar dhe të shpërndarë gjerësisht në shoqërinë e tyre.

4.2.2 RMV-ja në raport me kontratat elektronike

Në nivele të përgjithshme, shumica e shteteve, përfshirë edhe ato në rajonin e Ballkanit Perëndimor, kanë marrë hapa për të rregulluar dhe promovuar përdorimin e kontratave elektronike. Këto masa përfshijnë ligje specifike, të cilat përcaktojnë kushtet dhe kërkesat e kontratave elektronike, përdorimin e nënshkrimeve elektronike të siguruara, dhe mbikqyrjen e aplikimeve të kontratave elektronike.

Sa i përket Republikës së Maqedonisë së Veriut kontratat elektronike janë kryesisht të vlefshme përveç përjashtimeve të caktuara apo rasteve kur palët me marrëveshje shprehin se nuk dëshirojnë kontratë elektronike në mes tyre nëse kjo është e mundur varësisht llojit të marrëveshjes mes tyre.

Për qartësim të dilemave lidhur me këtë temë, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si ligje me të cilat mund të shërbehemi kur vijmë në përballje me një kontratë elektronike, janë Ligji për dokumente elektronike, identifikim elektronik dhe shërbime konfidenciale, Ligji për Tregti Elektronike, Ligji për Marrëdhëniet Detyrimore, Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit si dhe ligje të tjera të cilat indirekt mund të ndihmojnë në çështje të caktuara lidhur me kontratën elektronike varësisht prej natyrës së asaj kontrate.

Dokumenti elektronik ka të njëjtën fuqi ligjore dhe dëshmuese me formën e dokumentit të shkruar, në përputhje me ligjin.⁶⁴

Dokumenti elektronik nuk mund të kontestohet si provë në procedurë administrative apo procedure gjyqësore, vetëm sepse është krijuar në formë elektronike.⁶⁵

Kur forma me shkrim e dokumenteve ose akteve është e përcaktuar me ligj, dokumenti elektronik konsiderohet dokument ose akt në formë të shkruar.⁶⁶

Çështje me rëndësi për ne kur trajtohen kontratat elektronike janë nënshkrimi elektronik dhe vula elektronike.

Nga pikëpamja juridike, nënshkrimi elektronik si nënshkrim autograf në një dokument të shkruar ka funksion në komunikimin juridik, në marrëdhëniet financiare, në procedurat para organeve kompetente, në transaksionet bankare, krijon besimin e pjesëmarrësve në të gjitha format e komunikimi, si dhe për të parandaluar falsifikimin e paautorizuar dhe abuzime të tjera të dokumentit elektronik.⁶⁷

Nënshkrimi elektronik i duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

1. të shoqërohet/ lidhet në mënyrë unike me nënshkruesin;

⁶⁴ Neni 6, paragrafi 1, Ligji për Dokumentet elektronike, Identifikimet elektronike dhe Shërbimet Konfidenciale RMV “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.101/2019- 22.05.2019

⁶⁵ Po aty, paragrafi 2

⁶⁶ Po aty, paragrafi 3

⁶⁷ Нотарска Комора на Република Македонија, “Нотариус”, nr. 30, fq. 78 <https://rb.gy/i2ici>

2. të mundësojë identifikimin e nënshkruesit
3. të jetë krijuar me të dhëna për krijimin e nënshkrimit elektronik që nënshkruesi, me nivelin të lartë të besimit, mund t'i përdorë ato vetëm nën kontrollin e vet;
4. të shoqërohet me të dhëna që nënshkruhen në mënyrë të tillë që çdo modifikimi pasues i të njëjtit, të jetë i dukshëm;⁶⁸

Vula elektronike duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

1. të jetë e lidhur në mënyrë unike me menaxherin/ poseduesin e vulës;
2. të mundësojë identifikimin e menaxherit/ poseduesit të vulës;
3. që është krijuar me të dhëna për krijimin e vulës elektronike me të cilën menaxheri/ poseduesi i vulës, me një nivel të lartë besimi, mund t'i përdorë ato për të krijuar vulën elektronike;
4. lidhet me të dhënat që i vulos, në mënyrë të tillë që çdo modifikimi pasues i të njëjtit është i dukshëm;⁶⁹

Vlera provuese e një nënshkrimi elektronik nuk mund të kundërshtohet thjesht sepse është përdorur në formë elektronike ose sepse nuk i plotëson kushtet për nënshkrimi elektronik të kualifikuar.⁷⁰

Nënshkrimi elektronik i kualifikuar ka të njëjtën forcë ligjore dhe provuese si nënshkrimi me dorë.⁷¹

Forca provuese e vulës elektronike nuk mund të kontestohet thjesht sepse është përdorur në formë elektronike ose sepse nuk i plotëson kushtet për vulë elektronik të kualifikuar.⁷²

⁶⁸ Neni 38, Ligji për Dokumentet elektronike, Identifikimet elektronike dhe Shërbimet Konfidenciale RMV “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.101/2019- 22.05.2019

⁶⁹ Po aty, neni 39

⁷⁰ Po aty, neni 49, paragrafi 1

⁷¹ Po aty, paragrafi 2

⁷² Po aty, neni 50, paragrafi 1

Vula elektronike e kualifikuar është baza për prezumimin e integritetit të të dhënave dhe saktësinë e origjinës së të dhënave në batë të së cilit i njejt i është lëshuar.⁷³

Si organe të rëndësishme që vinë në shprehje kur bëhet fjalë për kontratat elektronike dhe dokumenete të tjera të sferës digjitale, përveç organeve të drejtësisë të cilat në rast kontesti e trajtojnë çështjen e caktuar, me rëndësi është edhe Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administrates e cila në kuadër të bashkëpunimi ndërkufitar i paraqet Komisionit Evropian raporte për aktivitetet në përputhje me rregulloren eIDAS, dhe kjo ministri i kryen detyrat e mëposhtme:

Zhvillimin dhe promovimin e shoqërisë informatike, krijimin dhe udhëheqjen e regjistrit të informacioneve dhe sistemeve komunikative si dhe paisjeve informatike brenda organeve shtetërore; rrjetin e integruar të informimit dhe komunikimit, bazat e të dhënave, ndërlidhjen mes veti dhe shkëmbimin e informatave, aspektet e sigurisë dhe zhvillimin e infrastrukturës në organet shtetërore, personat juridik dhe personat e tjerë të cilëve me ligj u është besuar kryerja e shërbimeve të autorizuara publike; ndjekjen e situatave të teknologjive informatike dhe telekomunikative si dhe vendosjen e standardeve ndërkombëtare; telekomunikacionet dhe infrastrukturën telekomunikative; radiodifuzionin dhe infrastrukturën radiodifuzive; rregullimin ligjor të çështjeve lidhur me administratën; mbykqyrjen dhe sigurimin e zbatimit të vetëm të rregulloreve që kanë të bëjnë me nëpunësit shtetëror dhe publik; zhvillimin e politikës lidhur me të drejtat, detyrimet, përgjegjësitë dhe vlerësimin e nëpunësve shtetëror dhe publik; klasifikimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, pagave dhe kompensimin e pagave të nëpunësve shtetëror dhe publik; udhëheqjen e Regjistrit të nëpunësve shtetëror dhe publik; përgatitjen e dokumenteve strategjike për punë efikase dhe efektive, trajnimin dhe zhvillimin profesional të nëpunësve shtetëror dhe publik; zhvillimin dhe koordinimin e politikave lidhur me udhëheqjen e burimeve njerëzore; reformën në administratën publike; realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar sipas çështjeve nga kompetenca e saj; si dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj.⁷⁴

Edhe Republika e Shqipërisë ngjason me shtetin tonë në lidhje me çështjen e kontratave dhe nënshkrimin elektronik.

⁷³ Po aty, paragrafi 2

⁷⁴ <https://www.mioa.gov.mk/5730.nspix>, marrë me 26.07.2023

“Nënshkrim elektronik” janë të gjitha të dhënat në formën elektronike, të cilat u bashkëlidhen ose shoqërojnë logjikisht të dhëna të tjera elektronike, që shërbejnë si një mënyrë e vërtetimit të identitetit të nënshkruesit dhe e vërtetësisë së dokumentit të nënshkruar.⁷⁵

Pëpros nënshkrimit elektronik që vjen në shprehje në rastet e lartëpërmendura, nga ana tjetër kemi edhe çështjen e mbrojtjes së konsumatorit, sepse mund të ndodhë që konsumatori gjatë realizimit të një blerjeje përmes internetit të ketë dhënë të dhënat e tij personale për kryerjen e blerjes së caktuar, e me këtë rast duhet patjetër të sigurohet që këto të dhëna të mos përdoren edhe për qëllime tjera.

Mbrojtja e konsumatorit është një temë mjaft e rëndësishme në botën digjitale, prandaj në RMV në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit sigurohet ndër tjerash që konsumatori, respektivisht qytetari në rastin kur për veprimine caktuar ndaj pales tjetër, respektivisht kur kryen blerje, pala shitëse duhet të sigurojë që të dhënat që i jepen në këtë rast të mos i përdor për qëllime të tjera pa lejen e blerësit pos qëllimit për të cilat këto të dhëna merren në rradhë të parë, kjo vlenë edhe për blerjet përmes internetit, ku në fakt në botën digjitale gjithmonë synohet që të merren të dhënat e blerësve gjithandej globit me qëllime të ndryshme nga pale të treta, e sidomos për qëllime të aspektit të përfitimeve monetare.

Tregtarit i ndalohet t'u japë palëve të treta të dhëna personale për konsumatorin personat, si dhe personat juridikë ose fizikë që veprojnë në kuadër të tyre edhe grup tregtarësh pa miratimin paraprak me shkrim të konsumatorit. Ndalohet kushtëzimi i blerjes së disa produkteve me blerjen e produkteve të tjera ose ndonjë mënyrë tjetër të kushtëzimit të blerjes dhe shitjes së produkteve.⁷⁶

⁷⁵ Neni 3, paragrafi 1, Ligji për “Për nënshkrimin elektronik”, nr. 9880, datë 25.02.2008, i ndryshuar nga ligji nr. 10178, datë 29.10.2009 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 21.09.2009 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”

⁷⁶ Neni 6, paragrafe 5, Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.38/04- 17.06.2004

4.2.3 Perspektivat e kontratave elektronike

Perspektivat e kontratave elektronike janë të ndryshme dhe shumë prej tyre lidhen me avancimet teknologjike të vazhdueshme dhe rritjen e përdorimit të mjeteve digjitale në shoqëri dhe ekonomi.

Kontratat elektronike pritet të vazhdojnë të shënojnë rritje në popullaritet dhe përdorim në të gjithë botën. Kjo do të ndikojë në uljen e shfrytëzimit të dokumenteve të shkruara me dorë dhe në rritjen e efikasitetit të proceseve të kontratave.

Një raport nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD) vlerësoi se shitjet globale të tregtisë elektronike biznes-biznes arritën në 22.4 trilionë dollarë në vitin 2015.⁷⁷

Nga kjo që u tha më sipër mund të kuptojmë se sa ndikim të madh në botën financiare kanë kontratat elektronike, dhe duke vërrejtur që digjitalizimi është në rritje e sipër, këto shifra pritet që në shënojnë rritje konstante.

Përdorimi i standardeve të përbashkëta dhe teknologjive të caktuara do të lejojë palët të ndërveprojnë dhe të krijojnë kontrata elektronike në mënyrë më lehtë dhe më efikasë, poashtu zhvillimi i teknologjive të sigurisë, përfshirë nënshkrimet digjitale, autentifikimit dy faktorësh dhe teknikat e tjera, i dhurojnë një nivel më të lartë sigurisë së kontratave elektronike.

Inteligjenca artificiale dhe makinat e mësimin do të mund të përdoren për të automatizuar proceset e kontratave, duke përfshirë identifikimin automatik të kushteve dhe monitorimin e tyre, ndërkaq teknologjia e “blockchain” do të përdoret për të siguruar transparencën dhe ndjekjen e kontratave elektronike, duke përmirësuar integritetin dhe besueshmërinë e tyre.

Kontratat elektronike do të luajnë një rol kyç në zhvillimin e biznesit të digjitalizuar, duke mundësuar më shumë inovacion dhe fleksibilitet në transaksionet e biznesit, ato do të lejojnë

⁷⁷<https://www.linkedin.com/pulse/countries-recognizes-e-signatures-business-esignly-solutions>,
07.08.2023

marrë me

transaksione më të lehta dhe më efikase ndërkombëtare, duke hapur rrugën për marrëdhënie biznesore dhe tregti ndërkombëtare më të suksesshme.

Përdorimi i kontratave elektronike do të kërkojë njohjen dhe pranimin e tyre në nivel ligjor, duke sjellë ndryshime në legjislacionin e shteteve të cilat nuk e kanë bërë deri më tani, por nga ana tjetër edhe përditësimi i ligjeve dhe rregullave nga shtetet të cilat i pranojnë kontratat elektronike.

Vlenë të përmenden edhe kontratat elektronike autonome, të cilat janë në gjendje të zbatohen dhe të menaxhohen vetvetiu përmes kodit kompjuterik, këto mund të zhvillohen në të ardhmen, ndonëse kjo ka sfida në aspektin juridik dhe etik të tyre.

Në përgjithësi, perspektivat e kontratave elektronike janë të ndritura dhe ata kanë potencialin të ndryshojnë mënyrën se si marrëveshjet dhe transaksionet zhvillohen në një shoqëri gjithnjë e më të digitalizuar. Megjithatë, është e rëndësishme të bëhet me kujdes adresimi i sfidave të sigurisë, privatisë dhe legjislacionit që lindin me përdorimin kontratave elektronike.

4.2.4 Sfidat e përdorimit të kontratave elektronike në praktikë

Kontratat elektronike dhe në përgjithësi zhvillimet teknologjike të kësaj natyre edhe pse kanë shënuar avancim të madh, kjo nuk do të thotë se për të njejtat nuk paraqiten sfida e të cilat në vete mbartin pasoja të caktuara. Prandaj do të ndalemi që në mënyrë të përgjithshme të përmendim disa nga këto sfida dhe pasoja potenciale të kontratave elektronike, sepse në këtë mënyrë mund të vihet deri në shmangien apo zgjidhjen e të nejtave.

Sfida dhe pasojat potenciale:

1. *Siguria dhe privatësia*: Rreziku i ndërprerjes së sistemit apo programit që i referohet sigurisë së kontratave elektronike dhe shkeljes së privatësisë është një sfidë potenciale. Kontratat elektronike duhet të mbrohen nga sulmet kibernetike dhe shfrytëzimi i të dhënave personale.
2. *Kostoja e ndërtimit dhe implementimit*: Ndërtimi dhe implementimi i platformave të kontratave elektronike mund të kërkojë investime të konsiderueshme të kohës dhe

burimeve financiare, por edhe më e rëndësishme se kaq është kostoja e mirëmbajtjes dhe kostoja në rast të paraqitjes së keq funksionimit të platformave apo mos funksionimi total të së njejtave.

3. *Barriera teknologjike*: Për individët dhe organizatat që nuk kanë qasje të lehtë në teknologji dhe internet, përdorimi i kontratave elektronike mund të jetë një sfidë, kjo mund të vijë në shprehje në shoqëri të cilat nuk kanë zhvillim të duhur në këtë drejtim siç janë vendet e botës së tretë, si dhe biznese të vendeve të tilla apo biznese të cilat nuk kanë dëshirë për të përdorur dhe për t'u qasur në botën digjitale.
4. *Kontestet ligjore dhe juridiksionet e ndryshme*: Kur kontratat elektronike janë të përdorura në mënyrë që rregullojnë marrëdhënie mes palëve të shteteve të ndryshme dhe që përfshijnë juridiksione të ndryshme, nëse nuk ekziston harmonizim i ligjeve që u referohen kontratave elektronike, ashtu që këto pale mund që këto çështje t'i rregullojnë në mënyra që bien ndesh mes tyre, kjo parashihet si një sfidë për kontratat elektronike sepse në disa juridiksione, rregulloret dhe praktikat e përdorimit të kontratave elektronike ende janë në zhvillim, duke krijuar kështu pasiguri ligjore për palët.
5. *Kredibiliteti*: Disa prej palëve pjesëmarrëse në një kontratë elektronike mund të kenë dyshime në lidhje me kredibilitetin e kontratës së tillë dhe mund të preferojnë lidhjen e kontratës në mënyrë tjetër, kjo do të bënte që të përdoret mënyra klasike e lidhjes së kontratës, raste të tilla janë më tepër evidente në shtetet tek të cilat përdorimi i teknologjisë refuzohet të përdoret për çështje me peshë juridike për shkak të njohurive jo të mjaftueshme në këtë drejtim.

4.3 Zhvillimet teknologjike dhe kontratat elektronike në raport me mjedisin jetësor

Kalimi në kontratat elektronike ka një efekt të fuqishëm mjedisor, pasi zhduket nevoja për printim fizik dhe ruajtje të kopjeve në letër, dhe rrjedhimisht, përdorimi përkatësisht i burimeve të letrës dhe printimit.⁷⁸

Zhvillimet teknologjike dhe përdorimi i kontratave elektronike kanë ndikim në mjedisin jetësor në mënyra të ndryshme. Këtu janë disa ndër lidhjet kryesore mes tyre:

1. *Ulja e përdorimit të letrës dhe burimeve natyrore:* Përdorimi i kontratave elektronike ul nevojën për dokumente të shtypura dhe burime natyrore të nevojshme për prodhimin dhe dërgimin e tyre. Ky është një kontribut pozitiv për mbrojtjen e pyjeve dhe uljen e ndikimit mjedisor të prodhimit të letrës.
2. *Reduktimi i dërgesës së postës fizike:* Kontratat elektronike janë dërguar dhe nënshkruar elektronikisht, e cila ul shfrytëzimin e makinave dhe energjisë për transportimin e dokumenteve fizike përmes mënyrës klasike të dërgesës me postë.
3. *Kosto më e ulët për transport:* Përdorimi i kontratave elektronike ndihmon në uljen e kostove të transportit të dokumenteve, duke përfshirë transportin me makinë dhe fluturim.
4. *Ndihma për mjedisin:* Zhvillimet teknologjike, përfshirë përdorimin e kontratave elektronike, janë përdorur për të ndihmuar në monitorimin dhe menaxhimin e ndryshimeve mjedisore dhe në mbështetjen e projektave të qëndrueshme të zhvillimit.
5. *Ndikimi potencial negativ:* Megjithatë, është e rëndësishme të përmendet se zhvillimi dhe përdorimi i teknologjive të reja, përfshirë të gjitha pajisjet dhe infrastrukturën e nevojshme për kontratat elektronike, ka ndikim në mjedisin jetësor. Përdorimi i burimeve të rralla dhe energjisë për prodhimin dhe përdorimin e pajisjeve digjitale mund të sjellë ndikime negative në ekosistemin global.

⁷⁸ <https://rb.gy/nhgvs>, marrë me 13.08.2023

6. *Menaxhimi i mbeturinave elektronike*: Kontratat elektronike janë një pjesë e përgjithshme e mjeteve digjitale, dhe në fund të jetës së tyre, duhet të menaxhohen me kujdes për të evituar ndotjen mjedisore nga mbeturinat elektronike.

Sipas një studimi të Komisionit Evropian, kontratat elektronike bëjnë të mundur për të kursyer bizneset e BE-së më shumë se 11 miliardë euro në vit, thjesht duke hequr nevojën për të printuar dokumente dhe për t'i menaxhuar ato manualisht. Kjo barazohet me një ulje prej 80-90% të kostove.⁷⁹

Përfundimisht, përdorimi i kontratave elektronike mund të ketë ndikim pozitiv në mjedis duke ulur përdorimin e burimeve natyrore dhe shfrytëzimin e energjisë, por është gjithashtu e rëndësishme të kemi parasysh ndikimin e përdorimit të teknologjisë në mjedis dhe të ndërmerren hapa për të zvogëluar ndikimin e mundshëm negativ në mjedisin jetësor.

4.4 Kontratat elektronike dhe përshtatja e tyre në shoqëri

Kontratat elektronike kanë ndikuar thellë në shoqëri, duke ndryshuar mënyrën se si marrëveshjet dhe transaksionet ndodhin dhe duke përmirësuar efikasitetin e tyre. Përshtatja e kontratave elektronike në shoqëri është një zhvillim i rëndësishëm dhe ka pasur ndikim në mënyrën se si operojmë në botën digjitale.

Në parim, rregullat e përgjithshme të formimit të kontratave janë gjithashtu të zbatueshme për kontratat elektronike. Edhe pse situata e tregtisë elektronike nuk e bën gjithmonë të lehtë njohjen e elementeve kontraktuale online, të gjitha këto elemente duhet të ekzistojnë në formimin e kontratave të vlefshme. Oferta elektronike dhe pranimi elektronik duhet të komunikohen para se të konsiderohen efektive. Palët që hyjnë në transaksion duhet të kenë aftësi ligjore si dhe qëllim ligjor për të u lidhur me kontratë.⁸⁰

⁷⁹ <https://rb.gy/4lb5y>, marrë me 04.08.2023

⁸⁰ Maryke Silalahi Nuth, "Electronic Contracting In Europe Benchmarking of National Contract Rules of United Kingdom, Germany, Italy and Norway in Light of the Eu E-Commerce Directive" Senter for rettsinformatikk/Avdeling for forvaltningsinformatikk, Postboks 6706 St Olavs plass, 0130 Oslo, fq. 33

Përshatja e kontratave elektronike në shoqëri është një pjesë e përgjithshme e procesit të digjitalizimit të shoqërisë dhe ekonomisë. Megjithatë, është e rëndësishme të kemi kujdes dhe të përdorim këtë teknologji me kujdes për të adresuar sfidat e sigurisë dhe privatisë dhe për të siguruar që të gjithë përdoruesit të kenë akses të barabartë dhe të kuptueshëm në këtë mënyrë të re të bërjes së marrëveshjeve.

Ndërtimi i besimit në mjedisin “online” është kyç për zhvillimin ekonomik dhe social. Mungesa e besimit, veçanërisht për shkak të mungesës së perceptuar të sigurisë ligjore, i bën konsumatorët, bizneset dhe autoritetet publike të hezitojnë të kryejnë transaksione në mënyrë elektronike dhe të miratojnë shërbime të reja.⁸¹

Për të mbështetur transaksionet elektronike në një mënyrë të ngjashme me transaksionet konvencionale, kontratat elektronike krijohen gjatë blerjeve dhe shitjeve online në tregjet elektronike. Tregjet elektronike janë platforma që ofrojnë mbështetje për transaksione tregtare për blerje ose shitje online të mallrave dhe shërbimeve. Kontratat elektronike dokumentojnë shprehjet e gatishmërisë gjatë transaksioneve tregtare.⁸²

Kontratat elektronike kërkohen, që të kryejnë të njëjtën funksion dhe të përmbushin të njëjtat kërkesa si kontratat konvencionale. Nga bazat e ligjit të kontratave dhe procesi i kontraktimit i përshkruar në seksionet e mëparshme, mund të përmbledhen kërkesat ligjore në vijim për kontratat elektronike:

- Identifikimi i qartë i palëve kontraktuese
- Tregimi i qartë i subjektit të kontratës
- Tregimi i qartë i periudhës së vlefshmërisë

⁸¹ Regulation (eu) no 910/2014 of the european parliament and of the council of 23 july 2014 on electronic identification and trust services for electronic transactions in the internal market and repealing directive 1999/93/ec, <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2014/910/oj>

⁸² Aspektet Ligjore të Kontratave Elektronike Infrastruktura për Po Bizneset ndaj Shërbimeve Dinamike nga Biznesi te Biznesi (IDSO'00) Stokholm, 5 - 6 Qershor 2000, fq. 3

- Kontrata duhet të ketë nënshkrime të vlefshme të palëve të përfshira që dëshmojnë pranimin e përgjegjësive të përcaktuara në kontratë. Nënshkrimi duhet të shoqërohet nga një datë që tregon fillimin e vlefshmërisë së kontratës.
- Mospërjashtim, pra askush nuk duhet të jetë në gjendje të ndryshojë përmbajtjen e kontratës pas nënshkrimit.⁸³

4.5 Raste studimi në shtete të ndryshme

Në SHBA, akti i Nënshkrimeve Elektronike në Tregtinë Globale dhe Kombëtare (ESIGN) ka vendosur një përkufizim të qartë të një nënshkrimi elektronik, duke e përbërë atë si "një zë, simbol ose proces i bashkangjitur ose i lidhur logjikisht me një kontratë ose regjistrim tjetër dhe të ekzekutuar ose adoptuar nga një person me qëllim të nënshkrimit të procesverbalit."

Po kështu në BE, një rregull i prezantuar në vitin 2018 synonte të standardizonte nënshkrimet elektronike në të gjitha shtetet anëtare, duke mundësuar bashkëpunimin ndërkufitar dhe duke reduktuar kohën dhe përpjekjen e nevojshme për detyra të ndryshme administrative. Rregullorja e Shërbimeve të Identifikimit, Autentifikimit dhe Mirëbesimit Elektronik (eIDAS) përcakton një nënshkrim të thjeshtë elektronik si "të dhëna në formë elektronike të cilat i bashkëngjiten ose lidhen logjikisht me të dhëna të tjera në formë elektronike dhe që përdoren nga nënshkruesi për të nënshkruar". Me fjalë të thjeshta, kjo do të thotë diçka aq e thjeshtë sa shkrimi i emrit tuaj nën një email mund të përbëjë një nënshkrim elektronik.⁸⁴

Ndër aktet me të cilat kontratat elektronike rregullohen në shtete të ndryshme mund të përmendim:

Shtetet e Bashkuara: Nënshkrimet Elektronike në Aktin e Tregtisë Globale dhe Kombëtare dhe Akti Uniform i Transaksioneve Elektronike; Kanada: Ligji për Mbrojtjen e Informacionit

⁸³ Po aty, fq. 7

⁸⁴ <https://rb.gy/4lb5y>, marrë me 05.08.2023

Personal dhe Dokumentet Elektronike; Australi: Akti i Transaksioneve Elektronike 1999; Bashkimi Evropian: Direktiva Evropiane 199/93/EC; Mbretëria e Bashkuar: Akti i Komunikimeve Elektronike 2000 dhe Rregullorja e Nënshkrimeve Elektronike 2002; Indi: Akti i Teknologjisë së Informacionit 2000; Japonia: Ligji në lidhje me Nënshkrimet Elektronike dhe Shërbimet e Çertifikimit; Kina: Ligji i Nënshkrimit Elektronik i Republikës Popullore të Kinës; Zelanda e Re: Akti i Transaksioneve Elektronike; Kombet e Bashkuara: Ligji model i UNCITRAL-it për nënshkrimet elektronike;⁸⁵

SHBA-të kanë një ligj të zhvilluar dhe të njohur për kontratat elektronike. Studimi i rasteve në SHBA mund të përfshijë përdorimin e kontratave elektronike në sektore të ndryshme, përfshirë blerjet online, kontratat e punës, dhe marrëveshjet ndërmjet korporatave.

Pas tyre rradhitet Estonia e cila është një prej vendeve më të avancuara në përdorimin e teknologjisë për administratën dhe shoqërinë. Studimi i rasteve në Estoni mund të përfshijë mënyrën se si qeveria e tyre ka integruar kontratat elektronike në shërbimet publike dhe bizneset lokale.

Britania e Madhe ka përdorur kontratat elektronike në sektorin e shëndetësisë dhe të shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Ky rast mund të ofrojë ide të mënyrave se si teknologjia mund të përdoret për të përmirësuar shërbimet shëndetësore dhe përdorimin e kontratave elektronike në këtë sektor.

Kina është një treg i madh për tregtinë elektronike dhe ka një përparësi të madhe në përdorimin e teknologjisë për blerjet online. Studimi i rasteve në Kinë mund të ofrojë një pamje të përdorimit të kontratave elektronike në tregun më të madh të e-blerjeve në botë.

Në Australi, nënshkrimet elektronike janë të zakonshme dhe përdoren rregullisht për transaksione biznesi. Çdo shtet dhe territor në Australi ka legjislacionin e tij të transaksioneve

⁸⁵ <https://rb.gy/ter00>, marrë me 05.08.2023

elektronike, të cilat shpesh pasqyrojnë Aktin e Komonuelthit ET, por përfshijnë disa përjashtime specifike.⁸⁶

Si një vend anëtar i BE-së, Gjermania ka njohur ligjërisht nënshkrimet elektronike që nga viti 2001, me Ligjin e Nënshkrimit Gjerman, i krijuar pas miratimit të Direktivës së BE-së në vitin 1999. Direktiva e BE-së u zëvendësua me Rregulloren e BE-së nr. 910/2014 në 2014, gjithashtu e njohur si Rregullorja eIDAS.

Ligjet kryesore në Gjermani që rregullojnë përdorimin e nënshkrimeve elektronike përfshijnë: Vertrauensdienstegesetz (VDG) ose Aktin Gjerman të Shërbimeve të Mirëbesimit që zbaton Rregulloren eIDAS dhe lehtëson përdorimin e shërbimeve të besimit elektronik sipas Rregulloreve eIDAS. Bürgerliches Gesetzbuch (BGB) ose Kodi Civil Gjerman, i cili, ndër të tjera, dikton se kur forma e shkruar mund të zëvendësohet me formën elektronike.⁸⁷

Studimi i këtyre rasteve të ndryshme në shtete të ndryshme do të ofronte një perspektivë të pasur mbi ndikimin dhe përdorimin e kontratave elektronike në nivel ndërkombëtar dhe do të ndihmonte në kuptimin e mënyrave se si kjo teknologji është përdorur dhe përshtatur në kontekste të ndryshme shoqërore dhe ekonomike.

⁸⁶ <https://shorturl.at/iDFZ2>, marrë me 09.08.2023

⁸⁷ Po aty, marrë me 09.08.2023

4.6 Anketë

Ky pyetësor është pjesë përbërëse e punimit shkencor *“Kontratave elektronike, sfidat dhe perspektivat e reja”*. Ndër qëllimet më kryesore të këtij hulumtimi është edhe mbledhja e të dhënave nga shoqëria jonë për të arritur në përfundimin se sa kanë njohuri mbi kontratat elektronike.

Pasi përdorimi i kontratave elektronike dhe në përgjithësi rritja e aktivitetit në botën digjitale dhe që prodhon efekt të caktuar juridik, ka vendosur legjislacionin e shteteve dhe shoqërinë përpara një sfide që prek sigurinë juridike të të gjitha palëve të involvuara në të.

Nga anketa e realizuar janë të përfshirë një numër i caktuar personash që përfshinë student dhe qytetar të rëndomt të moshave të ndryshme prej 18 deri në 65 vjeç. Nga të gjitha përgjigjet në anketë është arritur në një përfundim se si mendojnë një grup i vogël i shoqërisë në lidhje me kontratat elektronike.

1. A e dini çfarë janë kontratat elektronike ?

Nga personat e anketuar 85% e tyre u përgjigjën pozitivisht, duke pohuar se kanë dijeni se çfarë janë kontratat elektronike, kurse 15% i tyre u përgjigjën që nuk kanë dijeni.

2. A mund të na tregoni se çfarë janë kontratat elektronike ?

Edhe pse pyetja e parë është ngushtë e lidhur me pyetjen e dytë, në realitet nga të anketuarit vetëm 70% ishin në gjendje të tregojnë diçka që lejonte në nënkuptohet se kanë pak njohuri me atë se çfarë është kontratat elektronike, kurse pjesa tjetër nuk dhanë përgjigje e cila mund të konsiderohet si e mjaftueshme për të llogaritur se këto persona kanë njohuri mbi kontratën elektronike.

3. A keni blerë ndonjëherë përmes internetit ?

87% PO

13% JO

4. A keni nënshkruar ndonjëherë një kontratë në mënyrë elektronike ?

25% PO

75% JO

5. A mendoni se intelgjencia artificiale mund të ndikojë pozitivisht apo negativisht në systemin juridik të një shteti?

70% u përgjigjën se intelgjencia artificiale mund të ndikojë pozitivisht në sistemin juridik të një shteti pasi që nuk do të lejonte për gabime njerëzore në aspektin teknik.

30% e të anketuarve u përgjigjën se ndikimi mund të jetë negative, me arsyetimin se nuk kanë besim në çështje të tilla pasi rreziku nga ndërhyrjet e palëve të tjera dhe manipulimeve mund të jetë i lartë.

6. A mendoni se bota digjitale mund të lehtësojë jetën e shoqërisë në përgjithësi

85% e tyre u përgjigjën se bota digjitale mund të lehtësojë jetën e shoqërisë me arsyetimin se përmes përdorimit të internetit shumë lehtë mund të vendoset në dispozicion informacioni që kërkojnë.

15% ndanin mendim të kundrët me arsyetimin se me avancimet e tilla mund të humben shumë pozita pune dhe se bota digjitale ka nxjerrë nga jeta normale shoqërinë.

7. A mendoni se Republika e Maqedonisë së Veirut është në hap me kohën në aspekt ligjor sa i përket mbrojtjes së qytetarëve të saj në botën digjitale.

68% e tyre u përgjigjën pozitivisht, meqë RMV-ja është në procedure për anëtarësim në Unionin Evropian.

32% e tyre ndanin mendim negative për këtë pyetje pasi që nuk kishin besim në organet kompetente për çështje të tilla në RMV.

Për realizimin e këtij hulumtimi u konsultuan edhe 3 noterë nga rrethi i Gostivarit dhe Shkupit, në lidhje me atë se sa përdoren kontratat elektronike kur të njejtat duhet të vërtetohen në noter.

Nga këto intervista, në rradhë të pare morëm informatën se kontratat elektronike janë një realitet i pashmangshëm për të gjithë, përfshirë këtu edhe institucionet edhe individët, megjithatë në shtetin tonë ky realitet i përket të ardhmes pasi që aktualisht kontratat elektronike që duhet të vërtetohen në noter, realisht ndjekin mënyrën klasike, kurse noterimi elektronik ende është i pa rregulluar edhe ligjërisht, ashtu që një ndër procedurat që përfshinte gjithçka në rrugë elektronike tek noterët ishte çështja e tokës shtetërore, respektivisht shitja e tokës shtetërore, procedurat përkatëse me ligj, dhe noterimin elektronik, por që në realitet edhe këtu paraqiteshin vështirësi të caktuara.

Ata poashtu theksuan se kontratat elektronike dhe noterimi elektronik për ta do të paraqiste sfida në fillim por lehtësim në të ardhmen, kjo pasi që për përdorimin e tyre dhe të teknologjive përkatëse do të nevojitej që stafi dhe noterët të merrnin njohuritë dhe trajnimet e duhura për implementimin e këtyre risive, si dhe do të nevojitej që shoqëria me kalimin e kohës të pranojë këtë realitet dhe të marrë njohurinë bazike të nevojshme dhe asistencën gjatë realizimit të kontratave elektronike.

4.7 Konkluzione dhe rekomandime

Kontratave elektronike janë një instrument i rëndësishëm në shoqërinë tonë të digjitalizuar. Ato përbëjnë një risi në shumë drejtime e në veçanti në sferën juridike, duke paraqitur kështu një sfidë për juridiksionet e shteteve por që në thelb e gjithë kjo është përparësi pasi ajo ndikon në shpejtësinë, efikasitetin, aksesimin e lehtë, ruajtjen e mjedisit, sigurinë dhe integritetin e të dhënave, lehtësinë e nënshkrimit, ndjekjen dhe monitorimin e kontratave, uljen e kostove dhe kështu me rradhë. Për më tepër vlen të theksohet se kontratat elektronike janë aty për të thjeshtësuar punën për të gjitha palët pjesëmarrëse, me tejkalimin e rreziqeve që mund të paraqesë një kontratë elektronike ato shërbejnë si një instrument i domosdoshëm, kjo dëshmohet me përdorimin e madh të tyre në shumë drejtime, e megjithatë ka ende shumë punë, pasi në shumë shtete besimi tek kontratat elektronike nga pale të ndryshme është ende i ulur.

Ndërgjegjësimi dhe edukimi në lidhje me përdorimin dhe rregullat e kontratave elektronike janë po aq të rëndësishme. Duhet të sigurohemi që të gjithë përdoruesit e kontratave elektronike të kenë njohuri të mjaftueshme në këtë fushë. Kujdesi duhet të jepet veçanërisht në sektorë të rrezikshëm si shëndetësia dhe financat, ku përdorimi i kontratave elektronike duhet të jetë i kujdesshëm dhe duhet të monitorohet impakti i tyre në sfidat specifike të këtyre fushave. Duhet që patjetër palët gjatë përdorimit të kontratave elektronike të sigurohen që kontratat janë në përputhje me rregulloret dhe ligjet vendore aktuale. Nënshkrimi elektronik është synimi kryesor i kontratave elektronike, por është tërësisht i nevojshëm përdorimi i teknologjive të sigurisë për të garantuar integritetin dhe autenticitetin e nënshkrimit. Theks duhet të vendoset në përdorimin e platformave dhe mjeteve të nevojshme për ndjekjen dhe monitorimin e kontratave elektronike për të siguruar që ato të zbatohen në mënyrë korrekte dhe efikase.

Republika e Maedonisë së Veriut ka ende shumë punë për të bërë që kontratat elektronike të gjejnë zbatim në praktikë, kjo sidomos në drejtim të kontratave të cilat kërkojnë vërtetim nga noter i autorizuar, pasi që në atë drejtim nuk është punuar sa duhet, duke lënë të pa përditësuar ligjin për noteri ku shumë pak flitet për aspektin elektronik të kontratave respektivisht vërtetimit notarial elektronik të dokumentit. Megjithatë në sfera të tjera, siç janë përdorimi i kontratave elektronike

me pale që ofrojnë shërbimet e tyre përmes internetit, ato gjejnë zbatim dhe për të njëjtat parashihet mbrojtje e caktuar ligjore.

Ne duhet të shërbehemi me shembullin e shteteve të avancuara në drejtimin e përdorimit të kontratave elektronike, dhe të sigurohemi që të harmonizojmë ligjet pozitive të shtetit tonë në mënyrë që të jemi në të njëjtën vijë me atë çka parashohin këto shtete të përparuara por nga ana tjetër shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Nuk duhet të harrojmë që duhet në vazhdimsi të përdorim avancimet teknologjike që janë në dispozicion për të përmirësuar përdorimin dhe efikasitetin e kontratave elektronike në institucione, organizata dhe vende të tjera, e kjo vjen në shprehje gjatë gjithë kohës kur bëhet fjalë për kontratat elektronike, sepse për të pasur besim tek kontratat elektronike duhet të sigurohet që në rradhë të parë të përdoren platforma të sigurt kur përpilohen, dërgohen dhe nënshkruhen kontratat elektronike, pastaj identifikimi elektronik është një pike e rëndësishme në procesin e nënshkrimit e cila sigurisht që në të ardhmen do të gjejë zbatim edhe më të madh, ndërkaq teknologjia në këtë rast na ndihmon që në mënyrë të sigurt të arkivojmë dhe ruajmë dokumentacionin, respektivisht kontratën elektronike, e nga ana tjetër inteligjenca artificiale mund të na shërbejë e sidomos në të ardhmen do të mund të përdoret që përmes saj në kohë reale të na informojë që kontrata e hartuar është ose jo në përputhje me ligjet aktuale të vendit përkatës si dhe të identifikojë gabime të aspektit teknik edhe të aspektit ligjor.

Kontratat elektronike janë një realitet i shoqërisë sonë të digjitalizuar dhe janë të një rëndësie të madhe për ndërmarrjet, institucionet dhe individët. Duke respektuar rregullat dhe rekomandimet e mësipërme, palët pjesëmarrëse mund të përfitojnë numër të madh të përparësive që ofrojnë kontratat elektronike.

Përfundimi

Meqë zhvillimet e vazhdueshme teknologjike me vete mbartin anë pozitive dhe negative, e drejta pozitive e shteteve patjetër duhet të jetë në hap me këto zhvillime, duke parë rëndësinë e adaptimit të përdorimit të kontratave elektronike dhe ndikimit të tyre, në këtë punim u fokusuam që të tregojmë mbi pikat e rëndësishme të kontratave elektronike, duke përfshirë këtu edhe zbatimin e tyre në praktikë dhe pozitën e tyre në shtetin tonë.

Si rezultat i këtij hulumtimi, kanë vërtetuar hipotezat e parashtruara, ku krahas dhënies së propozimeve dhe rekomandimeve për përdorimin dhe avancimin e kontratave elektronike, hipotezat e parashtruara dhe të vërtetuara na lënë të kuptojmë rëndësinë dhe përdorimin e kontratave elektronike në nivel nacional, rajonal dhe në nivel ndërkombëtar.

Hipotezat e parashtruara për këtë punim janë: Pozita e kontratat elektronike në raport me avantazhet ndaj kontratave klasike dhe përdorimi i tyre në praktikë, përparësitë e kontratave elektronike dhe rreziqet që mund të sjellin ato, si dhe avancimi i shtetit tonë në raport me shtetet e zhvilluara në sferën e risive juridiko- teknologjike.

Nga këto hipoteza, duke shfrytëzuar burime të ndryshme dhe duke shfrytëzuar të dhënat nga anketa e realizuar, arritëm që të vërtetojmë se kontratat elektronike kanë avantazh në shumë aspekte në krahasim me kontratat elektronike, dhe nga ana tjetër kontratat elektronike janë domosdoshmëri dhe kontrata të vetme si opcion gjatë bërjes tregti përmes shfrytëzimit të internetit, por poashtu u vërtetua se në praktikë kur bëhet fjalë për kontrata që kërkojnë vërtetim noterial, të njejtat në shtetet e zhvilluara janë në përdorim e sipër kurse në shtetin tonë pothuajse nuk përdoren aspak, nga ana tjetër u ndalëm tek rreziqet e kontratave elektronike dhe tejkalimi i tyre dhe pozitën e shtetit tonë në raport me këto dhe zhvillime të tjera të botës digjitale.

Duke parë zhvillimin e shpejtë të risive që sjell teknologjia e që ndikon në avancimin e kontratave elektronike, pamë që është shumë me rëndësi se si ato pranohen nga shoqëria e shteteve të caktuara, çfarë niveli të edukimit dhe njohurisë ka shoqëria mbi ato, sa promovohet dhe përdoret nga institucione dhe persona që mund dhe duhet të shfrytëzojnë kontratat elektronike dhe e gjithë kjo na sjell në përfundimin se sa e nevojshme është ndërhyrja e institucioneve shtetërore që të

sigurohen mekanizma që këto kontrata dhe këto risi teknologjike të implementohen dhe të përdoren ashtu që do të fitohet besimi nga të gjithë palët potencialisht pjesëmarrëse në këto kontrata elektronike, duke tentuar që të tejkalohen zbrazëtirat ligjore përmes përditësimit të ligjeve përkatëse që i referohen kësaj teme.

Literatura

- Adnan Jashari, “E drejta afariste: (kontraktore)”, Tetovë, 2016
- Alajdin Alishani “Praktikumi nga e drejta e detyrimeve (Mendimet parimore, Vendimet nga praktika gjyqësore dhe dispozitat ligjore)”, Prishtinë, 1984
- Lubisha Millosheviq, “E drejta e detyrimeve (botimi i tretë)”, Prishtinë, 1983
- Enforceability of electronic contracts in light of the Ethiopian General Contract Law: appraising the issues.- <https://t.ly/fUkiH>
- Perez, Maria. "Electronic Contracting for Inter-Enterprise Collaboration." Thesis, Blekinge Tekniska Högskola, Avdelningen för interaktion och systemdesign, 2008, <http://urn.kb.se/resolve?urn=urn:nbn:se:bth-1249>.
- Polanski, Paul Przemyslaw, "Convention on E-Contracting: The Rise of International Law of Electronic Commerce?" (2006). BLED 2006 Proceedings. <https://aisel.aisnet.org/bled2006/20>
- Hillman, Robert A. and Rachlinski, Jeffrey John, Standard-Form Contracting in the Electronic Age. <https://ssrn.com/abstract=287819> or <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.287819>
- Shawn Pompian, ‘Is the Statute of Frauds Ready for Electronic Contracting?’ (1999) 85(7) Virginia LR 1447 marrë me 22.07.2023
- Ilmih, Andi Aina, and A. Zulkarnain. "IDEAL ELECTRONIC CONTRACT MODEL AS A FORM OF E-COMMERCE DISPUTES SETTLEMENT." *Jurnal Pembaharuan Hukum* 6, no. 1 (March 6, 2019): <http://dx.doi.org/10.26532/jph.v6i1.4463>.
- Edderouassi, Meryem. "Le contrat électronique International." Thesis, Université Grenoble Alpes (ComUE), 2017 <http://www.theses.fr/2017GREAD009/document>.
- The hybrid smart contract agreement challenge to European electronic signature regulation.- <https://t.ly/aLY1v>
- Ch. LARROUMET, « Droit civil : Les obligations, Le contrat, 1ère partie : Conditions de formation », t. III, 6ème Ed. ECONOMICA 2007

- Liisi Ju"rgen, Die elektronische Signatur nach europa"ischem, deutschem und estnischem Recht (Westfa"lische Wilhelms-Universita"t Mu"nster 2015)
- Enforceability of electronic contracts in light of the Ethiopian General Contract Law: appraising the issues.- <https://rb.gy/uozog>
- Мирослав Андоновски, Љупче Маркушески , Игор Здравкоски, Електронското склучување на договорите во развојот на електронската трговија <https://www.researchgate.net/publication/>
- Jalil, Md Abdul, and Leo D. Pointon. "Developments in electronic contract laws." *Computer Law & Security Review* 20, no. 2 (March 2004): [http://dx.doi.org/10.1016/s0267-3649\(04\)00020-2](http://dx.doi.org/10.1016/s0267-3649(04)00020-2).
- M. Chissick, Electronic Commerce – Law and Practice. London 1999
- Maryke Silalahi Nuth, "Electronic Contracting In Europe Benchmarking of National Contract Rules of United Kingdom, Germany, Italy and Norway in Light of the Eu E-Commerce Directive" Senter for rettsinformatikk/Avdeling for forvaltningsinformatikk, Postboks 6706 St Olavs plass, 0130 Oslo

LIGJET DHE DOKUMENTET NDËRKOMBËTARE

- Ligji përk Dokumentet elektronike, Identifikimet elektronike dhe Shërbimet Konfidenciale RMV "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.101/2019- 22.05.2019
- Ligji përk ndryshimin dhe plotësimin e ligjit përk marrëdhënie detyrimore i RMV-së "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.161- 30.12.2009
- Ligji përk Tregti Elektronike i RMV-së "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.133- 02.11.2007
- Ligji përk Mbrojtjen e Konsumatorit "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.38/04- 17.06.2004

- Ligji për “Për nënshkrimin elektronik”, nr. 9880, datë 25.02.2008, i ndryshuar nga ligji nr. 10178, datë 29.10.2009 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 21.09.2009 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”
- Ligji Model i UNCITRAL-it për Tregtinë Elektronike, me udhëzues për miratim, 1996: Me nenin shtesë 5 SHIB (BIS) të miratuar në 1998
- Regulation (eu) no 910/2014 of the european parliament and of the council of 23 july 2014 on electronic identification and trust services for electronic transactions in the internal market and repealing directive 1999/93/ec, <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2014/910/oj>
- DIREKTIVA (BE) 2016/680 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE TË KËSHILLIT e datës 27 prill 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale ose ekzekutimit të dënimeve penale, dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin Vendimi Kornizë i Këshillit 2008/977/JHA
- Direktiva Nr. 2000/31/KE për tregtinë elektronike
- Rekomandimi Nr. 31 nga edicioni i parë, i miratuar nga Qendra e Kombeve të Bashkuara për Lehtësimin e Tregtisë dhe Biznesit Elektronik (UN/CEFACT), Gjenevë, maj 2000 nën referencën e dokumentit ECE/TRADE/257.
- Aspektet Ligjore të Kontratave Elektronike Infrastruktura për Po Biznesest ndaj Shërbimeve Dinamike nga Biznesi te Biznesi (IDSO'00) Stokholm, 5 - 6 Qershor 2000

BURIME NGA INTERNETI

- Laws of electronic signature in different countries in 2022, <https://shorturl.at/iDFZ2>
- What are electronic contracts? How do they work, <https://rb.gy/vxloo>
- Electronic contracts aren't the future, they are the now, <https://rb.gy/4lb5y>
- Electronic Contracts (E-Contracts): The What, Why and How, <https://rb.gy/r2u1m>

- Risks with electronic signing - Have we been getting it all wrong, all this time?, <https://rb.gy/3kkd5>
- A better e-signature solution: RightSignature + ShareFile, <https://rb.gy/ter00>
- Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës <https://www.mioa.gov.mk/5730.nspX>
- Нотарска комора на република македонија, “Нотариус”, nr. 30, <https://rb.gy/i2ici>
- We start using electronic contracts through our partnership with evrotrust, <https://rb.gy/nhgvs>
- What Is an Electronic Contract?, <https://rb.gy/rkuus>
- Countries That Recognizes E-Signatures for Business, <https://www.linkedin.com/pulse/countries-recognizes-e-signatures-business-esignly-solutions>
- Switching to Digital Contract Management – Paperless Office, <https://rb.gy/n4f5b>
- Are There Any Risks Associated With Signing Contracts Electronically?, <https://rb.gy/swfcu>
- What are the key risks and benefits of using electronic signatures in contracts?, <https://rb.gy/z5zii>
- Law Bots: How AI Is Reshaping the Legal Profession, <https://rb.gy/ehj7p>